

Fjalori

Fjalori i mëposhtëm i termave është përgatitur nga autorët. Disa prej këtyre përkufizimeve bazohen në burime të jashtme dhe janë përshtatur për këtë Udhëzues Certifikimi për PPP, ndërsa të tjerët janë përgatitur nga autorët, për të pasqyruar përdorimin e zakonshëm dhe praktikën e mira.

Burimet kryesore të jashtme që janë përdorur për të përgatitur këtë Fjalor janë:

- Leksikoni: Laboratori i njohurive të PPP-së. Shih: <https://pppknowledgelab.org/glossary>
- Fjalori i termave të përgjithshëm të terminologjisë së PPP-ve – Scottish Futures Trust. Shih: http://www.scottishfuturestrust.org.uk/files/publications/SFT_Publication_PPP_Terminology_Glossary_Revised_January_2012.pdf
- Fjalori i termave për partneritetin publik-privat: Madhya Pradesh, Qeveria e Indisë. Shih: http://www.dif.mp.gov.in/ppp/PPP_Glossary.pdf
- Fjalori i dhënë në *Partneritetet publik-private: Parimet e politikave dhe financave* (2011), Yescombe, Botues ER: Butterworth-Heinemann.
- Fjalorët e dhënë në disa vëllime të *Udhëzimeve Kombëtare për Partneritetet Publik-Privat* (2008-2011), Qeveria Australiane, Infrastructure Australia. Shih: <http://infrastructureaustralia.gov.au/policy-publications/public-private-partnerships/files>
- Fjalori i dhënë në *Udhëzuesin për promovimin e qeverisjes së mirë në partneritetet publik-private* (2008), Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën, në: <http://www.unece.org/fileadmin/DAM/ceci/publications/ppp.pdf>

Braktisja	Dështimi i partnerit privat në ndërtimin ose vënien në punë të objektit për një periudhë të zgjatur kohore.
Pranimi	Konfirmimi nga autoriteti publik ose certifikuesi i pavarur se janë përmbushur kushtet e disponueshmërisë së shërbimit.
Projektet e akomodimit	Projektet e PPP-së që kanë të bëjnë me sigurimin e objekteve siç janë shkollat, spitalet dhe burgjet.
Afermazh	Term francez, i cili përdoret për të emërtuar një formë të PPP-së, ku partneri privat është përgjegjës për operimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës ekzistuese, por jo për financimin e investimit. Partneri privat nuk merr tarifë fikse për shërbimet e tij. Në vend të kësaj, ai merr një

	<p>pjesë të tarifave të përdoruesve, ku një pjesë e faturave i kalojnë autoritetit të prokurimit, si pronar i sendit. Pagesa për autoritetin e prokurimit është një përqindje e faturave ose përqindje e njësisive totale të shërbimit të ofruar.</p>
Përballueshmëria	<p>Aftësia e një projekti të realizohet realisht përbrenda kufizimeve kohore dhe buxhetore të qeverisë.</p>
Vlerësimi	<p>Realizimi i një sërë veprimesh të fizibilitetit që shërbejnë si bazë për vendimin për të miratuar, anuluar ose rishikuar projektin para strukturimit të kontratës.</p>
Rreziqet e alokimeve	<p>Rreziku që agjencia publike nuk do të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj financiare ndaj projektit, sepse fondet për projektin nuk alokohen apo zotohen në buxhetin e saj. Rreziqet e alokimit mund të ndikojnë në projektet në të cilat agjencia publike pritet të bëjë pagesa në formën e shumave të sheshta gjatë periudhës së ndërtimit, si pagesa të disponueshmërisë gjatë kohëzgjatjes së projektit, ose si rezultat i ngjarjeve të tjera që paraqiten gjatë kohëzgjatjes së projektit.</p>
Arbitrazhi	<p>Një formë private e gjykimit ku palët mund të zgjedhin një palë të tretë / panel të paanshëm, në bazë të një marrëveshjeje me shkrim. Secila palë mund të zgjedhë arbitrin e vet, bazuar në ekspertizën dhe praktikën e dëshiruar, ndërsa emërohet edhe një arbitër i pavarur. Palët janë të lira të hartojnë dhe rregullojnë rregullat e arbitrazhit. Vendimi i arbitrit është ligjërisht detyrues në shumicën e rrethanave.</p>
Arrendamiento (dhënia me qira e të mirave publike)	<p>Një alternativë ligjore ndaj kontratave të tipit Projektim - Ndërtim - Financim - Operim - Mirëmbajtje (DBFOM), të paguara nga qeveria, ku toka në të cilën do të ndërtohet një objekt nuk është tokë për përdorim publik. Në vend të kësaj, janë pasuri të paluajtshme që mund të tjetërsohen nga qeveria.</p>

Statuti		Dokumenti që përcakton qëllimin e subjektit për qëllime të veçanta (SPV) dhe rregullat që rregullojnë mënyrën se si do ta drejtojnë atë organet e saj drejtuese. Shih gjithashtu <i>Subjekt për Qëllime të Veçanta</i> .
Padisponueshmëria		Padisponueshmëria e shërbimeve, që prek një ose më shumë zona funksionale ose njësi të objektit.
Pagesat disponueshmërisë	e	Pagesat që bëhen gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, në këmbim të të cilave, pala private vë në dispozicion infrastrukturën. Kjo përcaktohet në kontratë dhe është një formë e zakonshme e pagesës në PPP-të e tipit qeveria paguan.
Rreziku disponueshmërisë	i	Kjo i referohet rrezikut (sidomos nga këndvështrimi publik) që infrastruktura të mos jetë në dispozicion për t'u përdorur dhe / ose të mos përmbushë kushtet e cilësisë ose nivelet e pritshme të performancës.
Bankabiliteti për bankat)	(atraktiviteti	Aftësia e një projekti për t'u pranuar nga huadhënësit si një investim në kuadër të një skeme të financimit të projektit, ose aftësia e projektit për të mbledhur një sasi të konsiderueshme të financimit me anë të huave afatgjata në bazë të financave të projektit, për shkak të atraktivitetit financiar të projektit, për nga mjaftueshmëria dhe besueshmëria e rrjedhave të ardhshme monetare.
Pikënisja bazë		Përshkrimi financiar i projektit për sa i përket kostove, të ardhurave dhe konkluzionet pasuese. Kombinon variablat e ndjeshmërisë për të shqyrtuar skenarin më të mundshëm.
Modeli financiar pikënisjes bazë	i	Modeli financiar i pikënisjes bazë, i dakordësuar ndërmjet palëve në datën e mbylljes financiare. Mund të azhurnohet, ndryshohet dhe të përshtatet herë pas here. Modeli financiar i pikënisjes bazë zakonisht përfshin të gjitha kostot, të ardhurat dhe pagesat ndërmjet palëve, së bashku me të gjithë parametrat dhe supozimet që janë në themel të këtyre llogaritjeve.
Plani kohor		Plani kohor i projektit i përgatitur për qëllime koordinimi

	<p>dhe monitorimi. Përdoret për të identifikuar rrugën kritike dhe pothuajse kritike të projektit të cilat, nëse vonohen, rezultojnë në vonesa të përgjithshme të përfundimit të projektit.</p>
Kalibrimi (benchmarking)	<p>Krahasim i kostos së një artikulli ose shërbimi kundrejt çmimit të tregut për atë artikull ose shërbim.</p> <p>Në kontekstin e PPP-ve të paguara nga qeveria, me një komponent relevant të "shërbimeve të buta" (për shembull, në PPP-të shëndetësore, shkolla, etj.), kalibrimi përdoret si një metodë për të llogaritur përshtatjet e çmimeve me pagesat e shërbimeve, bazuar në shqyrtimin e çmimeve të tregut për shërbime të tilla (për shembull, krahasimi i kostove të partnerit privat ose kontraktuesve të tyre me çmimin real të atyre shërbimeve të buta në treg).</p> <p>Vlerësimi kundrejt një modeli referues (kalibrimi) është një alternativë për "testimin e vlerës", qëllimi i së cilës është të testohet nivelin real i kostove të shërbimeve të buta kundrejt tregut; kjo është alternativa tjetër, që përdoret më së shpeshti për të zëvendësuar testimin e tregut.</p>
Oferta më e mirë dhe përfundimtare (BAFO)	<p>Si pjesë e fazës së Kërkesës për Propozim (KpP), ky është një proces i mëtejshëm i përzgjedhjes, për të përcaktuar një ofertues të preferuar.</p> <p>Shih gjithashtu <i>Kërkesa për propozim, Faza e KpP-së</i>.</p>
Garancia e ofertës	<p>Një garanci me shkrim që pala private i dorëzon autoritetit të prokurimit. Garancia e ofertës ka për qëllim të sigurojë që nëse zgjidhet, ofertuesi do të lidh kontratën. Njihet gjithashtu edhe si një "garanci e dorëzimit të ofertës".</p> <p>Garancia e ofertës i kthehet ofertuesit të suksesshëm pas hyrjes në fuqi të kontratës përkatëse apo pas mbylljes financiare.</p>
Bonusi i ofertës	<p>Në rastet e propozimeve të pakërkuara, subjekti propozues përfiton pikë shtesë në garë - një përqindje</p>

	shtesë i shtohet pikëve të vlerësimit të tij - në një procedurë të hapur.
Garancia e paraqitjes së ofertës	Shih <i>garancia e ofertës</i> .
Ofertuesi (ose subjekti propozues)	<p>Në kuptimin e gjerë, shoqëria ose një grup shoqërisht, siç është konsorciumi, që paraqesin një ofertë në përgjigje të një KpP-je. Ofertuesi mund të jetë një palë e vetme ose një konsorcium i palëve, secila përgjegjëse për një element të veçantë, siç janë ndërtimi i infrastrukturës, furnizimi i pajisjeve ose operimi i biznesit.</p> <p>Në kuptimin e ngushtë, ofertuesi është vetëm shoqëria ose shoqëritë që zotohen të formojnë shoqërinë e projektit ose partneri privat (i cili gjithashtu njihet edhe si SPV), me anëtarët e tjerë të konsorciumit ofertues që veprojnë potencialisht si "kontraktuesi i nominuar". Qeveria zakonisht kontrakton vetëm me shoqërinë ose shoqëritë që formojnë SPV-në, ose me vetë SPV-në.</p>
Shkelje e kontratës	Shih <i>Shkelja e kontratës</i> .
Kostoja e shkeljes	Kostoja e ndërprerjes së hershme të një shkëmbimi (swap), bonoje, apo huaje tjetër me normë fikse apo të indeksuar sipas inflacionit.
Projektet e fushës së kaftë (Brownfield)	<p>Nga një perspektivë teknike / inxhinierike, investimet në projekte në kantiere që janë përdorur më parë për qëllime industriale ose kanë qenë vendndodhja e ndërtesave të rëndësishme.</p> <p>Nga këndvështrimi i investitorit, investimet e projektit në asetet e infrastrukturës që ekzistojnë para kohës së prokurimit ose që paraprakisht ishin fusha të gjelbra por janë në funksion në kohën kur bëhet investimi.</p>
Arsyeshmëria afariste	Dokumenti që artikulon arsyetimin për ndërmarrjen e një investimi.

Kalibrimi	Procesi i rafinimit dhe i caktimit të numrave dhe vlerave përfundimtare pjesëve të ndryshme të mekanizmit të pagesës.
Shpenzimet kapitale - Capex	Shpenzimet kapitale (Capex): Kostot fillestare të ndërtimit të infrastrukturës plus çdo shpenzim për pasuritë e ndërtuara përmes PPP e që nuk janë shpenzim operativ (Opex).
Modeli i Caktimit të Çmimit të Aktiveve Kapitale (CAPM)	Teknika për vlerësimin e normës së zbritjes, që aplikon një investitor kur vlerëson një aset financiar, ose kthimin e kapitalit që kërkon ai investitor. CAPM llogarit zbritjen (ose normën e brendshme të kthimit të ekuitetit [IRR) mbi bazën e një norme të investimit pa rrezik, së cilës i shtohet një prim i rrezikut të tregut, i përshtatur për profilin e rrezikut të sektorit.
Grantet kapitale ose financimi i granteve	Pagesat e grantit ose subvencionet kapitale që paguhen nga qeveria për të financuar drejtpërdrejt një pjesë të kostove të projektit. Gjithashtu quhen "bashkëfinancim".
Tregjet e kapitalit	Tregjet që kanë të bëjnë me mbledhjen/ngritjen e kapitalit duke blerë dhe shitur borxhe dhe ekuitet, tregti me aksione, obligacione dhe investime të tjera afatgjata.
Parakushti 22	Kusht që nuk mund të plotësohet derisa të plotësohet një parakusht paraprak; mirëpo, parakushti nuk mund të sigurohet derisa nuk plotësohet kushti fillestar.
Agjencitë qendrore	Ministritë ose departamentet qeveritare që kanë përgjegjësi për politikën mbarë-qeveritare. Shembuj përfshijnë ministrinë e financave dhe ministrinë e planifikimit.
Ndryshimi në ligj	"Ndryshimi në ligj" zakonisht përfshin ngjarjet e mëposhtme që ndodhin pas nënshkrimit të kontratës së projektit: (a) Miratimi i ligjeve të reja

	<p>(b) Amendimi, shfuqizimi ose ndryshimi i ndonjë ligji</p> <p>(c) Në disa juridiksione, çdo vendim i një gjykate përkatëse, që ndryshon një precedent detyruës.</p>
E drejta civile	<p>E drejta civile është e kodifikuar. Kodet e tilla bëjnë dallim ndërmjet kategorive të ndryshme të së drejtës: e drejta materiale përcakton se cilat akte i nënshtrohen ndjekjes penale ose ndjekjes civile, e drejta procedurale përcakton se si të konstatohet nëse një veprim i caktuar përbën një vepër penale dhe e drejta penale përcakton dënimin e duhur. Në sistem e të drejtës civile, roli i gjyqtarit është të përcaktojë faktet e lëndës dhe të zbatojë dispozitat e kodit në fuqi. Pjesa më e madhe e të drejtës civile buron nga “<i>Kodi i Napoleonit</i>”</p>
Bashkëfinancimi	<p>Bashkëfinancimi nënkupton, në kontekstin e PPP-së, sigurimin e financave nga sektori publik për të financuar një pjesë të shpenzimeve kapitale (Capex). Kur financimi buron nga financat publike në kuptimin e ngushtë (financat që burojnë nga mjetet buxhetore, zakonisht konsiderohen "pagesa të granteve" ose "financim të granteve", dhe jo financat që ofrohen nga agjencitë publike financiare apo nga bankat publike), ato mund të quhen bashkëfinancime.</p> <p>Bashkëfinancimi zakonisht ndërlidhet me projekte jorentabël të tipit ‘përdoruesi paguan’, në mënyrë që të plotësohet hendeku i rentabilitetit, por ai gjithashtu mund të aplikohet për PPP-të ‘qeveria paguan’, për të rritur fitueshmërinë, ose për të rritur përballueshmërinë e projektit.</p>
Bashkë-huadhënësit	<p>Kur agjencitë financiare publike ndihmojnë për të plotësuar hendekun e kredisë, duke ofruar një pjesë të kredisë. Këto agjenci japin hua me kushte të ngjashme si komuniteti bankar.</p>
Garancitë e kolateralit	<p>Një palë që lidh kontratë me subjektin për qëllime të veçanta (SPV), siç janë këshilltarët profesional ose nënkontraktuesit, i jep disa zotime dhe garanci</p>

	drejtpërsëdrejti bankës, që puna që ajo kryen do të jetë e përshtatshme për qëllimin dhe do të jetë në përputhje me të gjitha ligjet përkatëse; dhe se do të mbajë një shumë minimale të sigurimit për një periudhë të caktuar.
Bankat tregtare	Bankat në pronësi private që ofrojnë kredi, të njohura si borxhe, për subjektin për qëllime të veçanta (SPV), të cilat i mundësojnë këtij të fundit financimin e aktiviteteve të projektit.
Mbyllja financiare	<p>Momenti kur bihet dakord mbi të gjitha çështjet madhore financiare ndërmjet autoritetit të prokurimit dhe konsorciumit. Kontrata e PPP-së (ose marrëveshja e projektit të PPP-së) zakonisht nënshkruhet pas mbylljes financiare.</p> <p>Ndonjëherë, edhe nëse kontrata e PPP-së është nënshkruar, shumica e dispozitave të saj nuk hyjnë në fuqi derisa të mos arrihet mbyllja financiare.</p>
Fizibiliteti tregtar	<p>Analiza që bëhet për të verifikuar nëse projekti do të tërheqë ofertues, investitorë dhe huadhënës cilësorë, si dhe për të nxjerrë në pah kushtet kryesore që duhet të plotësohen për ta realizuar këtë.</p> <p>Gjithashtu përfshin edhe "fizibilitetin financiar".</p>
Komisionimivënia në punë	Kolaudimi që kryhet në përfundim të ndërtimit të një projekti për t'u siguruar që partneri privat ka përbushur të gjitha parakushtet e nevojshme që projekti të fillojë të vihet në punë, dhe dëshmon se infrastruktura mund të ofrojë shërbimet në përputhje me specifikimet e rezultatit/produktit. Ndonjëherë quhet edhe përfundimi i projektit ose përfundimi i ndërtimit; kjo e fundit i referohet më shumë përfundimit të punimeve të ndërtimit përpara kolaudimit dhe inspektimit nga autoriteti, për t'u siguruar që aktivi është i gatshëm të ofrojë shërbimin, ashtu siç specifikohet në kontratë.
Rreziku i komisionimit	Rreziku i mosarritjes së rezultatit të parashikuar të ndërtimit, dhe/ose rreziku që projekti i ndërtuar të mos

		përbushë kriteret e pranimit përfundimtar, , duke shkakuar vonesë në fitimin e të ardhurave.
E drejta zakonore		<p>E drejta zakonore zakonisht është e pakodifikuar. Kjo do të thotë që nuk ka një trup gjithëpërfshirës të rregullave dhe ligjeve.</p> <p>Edhe pse e drejta zakonore mbështetet në disa akte të pakta, të cilat janë vendime legjislative, ajo kryesisht bazohet në precedent, e të cilat janë vendimet gjyqësore që tashmë janë marrë në raste të ngjashme.</p>
Komonuelthi		Komonuelthi është një shoqatë vullnetare e 53 shteteve të pavarura dhe të barabarta sovrane. Origjina e saj rrjedh nga Perandoria Britanike, kur disa vende sundoheshin, në mënyrë direkte ose indirekte, nga Britania. Anëtarësimi sot bazohet në bashkëpunim falas vullnetar dhe të barabartë; nuk kërkohen lidhje historike me Perandorinë Britanike.
Infrastruktura komunikimit	e	Infrastruktura e ndërtuar për transmetimin e rrjeteve të telekomunikimit dhe atyre të transmetimit.
Ngjarjet e kompensimit		Ngjarjet e rrezikut për të cilat partneri privat ka të drejtë të marrë kompensim financiar, nëse ajo ngjarje ndodh dhe nëse partneri privat preket prej saj. Kompensimi mund të jetë vetëm i pjesshëm, pra ngjarja quhet rrezik i përbashkët.
Procesi i dialogut konkurrues		<p>Një lloj i veçantë i procesit të tenderit ku ekziston një fazë specifike, e quajtur "faza e dialogut", në të cilën kontrata dhe Kërkesa për Propozim (KpP) diskutohen ose i nënshtrohen dialogut ndërmjet autoritetit dhe kandidatëve (një nga një), ose me ofertuesit e mundshëm (të para-zgjedhur ose nga lista e ngushtë, në bazë të Kërkesës për Kualifikime - KpK).</p> <p>Qëllimi është që të përpunohet kontrata dhe KpK para se të kërkohet oferta (ose para ofertës përfundimtare kur ofertat e mëparshme janë thirrur gjatë dialogut, zakonisht në rastet kur janë jo-detyruese).</p>
Përfundimi		Kur pala private të ketë ndërtuar objektin sipas

	kërkesave të qeverisë dhe objekti vlerësohet i përshtatshëm për marrje në dorëzim dhe përdorim.
Sigurimi i përfundimit	Siguria që ofrohet nga nënkontraktuesi i ndërtimit për respektimin dhe përmbushjen e nën-kontratës së ndërtimit.
Rreziqet e përfundimit	Rreziqet lidhur me përfundimin e ndërtimit të objektit dhe aftësinë e tij fillestare për të ofruar shërbimet e parashikuara në kontratën e PPP-së.
Koncesion	Dhënie e të drejtave ekonomike të pasurisë publike në një juridiksion të së drejtës administrative për një palë private nga qeveria, përfshirë titullin ligjor për ta poseduar vendndodhjen. Mund gjithashtu t'i referohet një kontrate të PPP-së, e cila zakonisht rezervohet për kontrata ku shumica e të ardhurave vijnë nga përdoruesit.
Koncesionari	Shih <i>partneri privat</i> .
Kushtet paraprake	Kushtet të cilat shoqëria e projektit duhet t'i plotësojë para se të tërheq borxhin, ose para se kontratat e projektit të hyjnë në fuqi.
Konsorciumi	Konsorcium është një grup shoqërorish që janë bashkuar për të parashtruar ofertë për një projekt. Është dukuri e shpeshtë që shoqëritë të formojnë konsorciume për të bërë oferta për projekte të PPP-së, pasi kjo u mundëson atyre që t'i mbledhin të gjitha kapacitetet nevojshme për projektin (për shembull, ndërtimi, operimi i infrastrukturës dhe kapacitetet e financimit).
Marrëveshja konsorciumit	e Marrëdhënia kontraktuale ndërmjet anëtarëve të konsorciumit. Zakonisht përcakton me hollësi të konsiderueshme sesi përgjegjësitë, rreziqet dhe përfitimet ndahen dhe / ose alokohen ndërmjet anëtarëve. Nëse oferta shpallet fituese, për shembull, konsorciumi bëhet ofertuesi i preferuar dhe lidh kontratën e PPP-së.
Kontrata e ndërtimit	Marrëveshje e lidhur ndërmjet subjektit për qëllime të veçanta (SPV) dhe kontraktuesit të ndërtimit për

	projektimin dhe ndërtimin e veprave të projektit të PPP-së. Gjithashtu quhet edhe "kontratë e tipit projektim, ndërtim (DB)", "kontratë e tipit projektim, zbatim dhe ndërtim (DaC)", ose "kontratë e tipit inxhinieri, prokurim, ndërtim - EPC".
Kontraktuesi i ndërtimit	Pala ose grupi i palëve (në kuadër të një konsorciumi të ndërtimit ose forme tjetër të sipërmarrjes së përbashkët) e cila është përgjegjëse për projektimin dhe ndërtimin e veprave të projektit të PPP-së, si dhe për sigurimin e të gjithë materialit, krahut të punës, pajisjeve (siç janë mjetet apo veglat inxhinierike), si dhe shërbimet e nevojshme për ndërtimin e projektit. Gjithashtu përfshin "Kontraktuesin për Projektim dhe Ndërtimit (D&C)" ose "Kontraktuesin për Inxhinieri-Prokurim-Ndërtim (EPC)".
Faza e ndërtimit	Periudha nga mbyllja financiare deri në realizimin e komisionimit, gjatë së cilës përfundojnë punimet e ndërtimit.
Rreziku i ndërtimit	Mundësia që, gjatë Fazës së Projektimit dhe Ndërtimit, kostot aktuale të projektit ose koha e ndërtimit të tejkalojnë ato të parashikuara.
Kontingjenca	Rezerva e pa alokuar në buxhetin e shpenzimeve kapitale (Capex) për të mbuluar ndonjë kosto të papritur, por të nevojshme, të shpenzimit kapital. Mbulohet nga fondet rezervë ose fondet e gatishmërisë.
Rezerva kontingjence	Rezerva për të trajtuar kontigjencat / rreziqet të cilat mund të çojnë në dështim të shërbimit dhe / ose mos pagesë nga ana projektit. Si partnerët privatë ashtu edhe ata publikë mund të krijojnë rezerva kontingjence.
Garancitë kontingjente	Garancitë kundër një ngjarjeje ose rrethane të ardhshme që është e mundur, por që nuk mund të parashikohet me siguri dhe që mund të ndikojë në të ardhurat e projektit, për shembull, garancitë e trafikut minimal.
Detyrimet kontingjente	Detyrimet/përgjegjësitë që shkaktohen nga ndonjë ngjarje e veçantë, por e pasigurt në të ardhmen. Ky Udhëzues Certifikimi për PPP aplikon këtë term posaçërisht për ato detyrime të cilat prekin qeverinë

	sipas kontratës së PPP-së.
Fondi për detyrimet kontingjente	Një llogari (e cila mund të jetë brenda ose jashtë llogarive të qeverisë), në të cilën bëhen transferta paraprakisht, dhe nga e cila bëhen pagesat për detyrimet kontingjente të shkaktuara, të cilat paguhen në maturitet. Njihet gjithashtu si "fond i garancisë".
Shkelja e kontratës	Mosrespektimi i një dispozite të kontratës. Kjo mund të çojë në ndëshkime por edhe në ngjarje të mospërbushjes së kontratës. Njihet gjithashtu si "shkelje kontrate".
Mospërbushja e kontratës	Shkelje e kontratës që ka të bëjë me një detyrim të konsideruar qenësor në kontratë (përfshirë shkelje të përsëritura), e cila i jep të drejtë autoritetit prokurues ta zgjidhë kontratën. Për t'u konsideruar si mospërbushje, një shkelje zakonisht duhet të jetë një shkelje materiale e detyrimit përkatës. Njihet gjithashtu edhe si "ngjarje apo rast mospërbushjeje".
Ekzekutimi i kontratës	Nënshkrimi i kontratës. Shih <i>mbyllja financiare</i> .
Menaxhimi i kontratës	Procesi i menaxhimit dhe administrimit të kontratës së PPP-së nga momenti kur bihet dakord për nënshkrimin e kontratës e deri në fund të afatit të kontratës.
Manual për menaxhimin e kontratës	Mjeti për menaxhim të njohurive për planifikimin e trajnimit dhe të përcjelljes së njohurive përmes ekipit. Është gjithashtu një udhëzues që thekson veprimet më të menjëhershme dhe kritike që duhet të ndërmerren nga drejtori i kontratës gjatë administrimit të kontratës.
Nënshkrimi i kontratës	Shih <i>mbyllja financiare</i> .
Vlera e kontratës	Vëllimi i shpenzimeve kapitale (Capex) përlllogaritur nga autoriteti prokurues. Ndonjëherë i referohet shumës totale të pagesave që duhet të bëhen nga autoriteti

	<p>prokurues, nëse oferta është e barabartë me tavanin e pagesave.</p>
<p>Inxhinieri i ndërtimit, zbatimit dhe inspektimit (CEI)</p>	<p>Inxhinieri i CEI-së ose një inspektor i CEI-së bën mbikëqyrjen dhe ofron mbështetje për inspektim, për të monitoruar punimet që bëhen gjatë fazës së ndërtimit deri në momentin e komisionimit, përfshirë.. Inxhinieri i CEI-së kontraktohet nga autoriteti i prokurimit dhe është në varësi të tij, por nuk jep aprovime të detyrueshme.</p> <p>Kur mendimi dhe analiza e kryer nga një inxhinier që monitoron punimet është detyrues dhe inxhinieri vepron si një agjent i pavarur, kjo pozitë zakonisht quhet <i>inxhinier i pavarur</i> ose <i>certifikues i pavarur</i> (shih përkufizimin e veçantë në këtë fjalor).</p>
<p>Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK)</p>	<p>Matës i inflacionit; matësi zyrtar i inflacionit në një shtet. Gjithashtu njihet si Indeksi i Çmimit me Pakicë (IÇP).</p>
<p>Prokurimi konvencional</p>	<p>Mënyra prokurimi, përveç PPP-ve, të cilat mund të përdoren më së shumti për realizimin e veprave publike.</p>
<p>Analiza e kostos dhe përfitimit (CBA)</p>	<p>Një lloj analize që përdoret për të krahasuar dy ose më shumë opsione për një projekt ose një vendim bazuar në rrjedhat ekonomike, të cilat përshtaten në bazë të disa modeleve. CBA përdoret zakonisht për të vlerësuar fizibilitetin ose vlerën socio-ekonomike të projektit të zgjedhur ose projektit në vlerësim e sipër (pavarësisht nga mënyra e prokurimit).</p>
<p>Analiza e efektivitetit të kostos (CEA)</p>	<p>CEA lidh koston e një alternative me një masë të objektivave të projektit ose me rezultatet ose përfitimet kryesore të tij. Për shembull, mund të jenë dollarë për kohë, që kursehen në sisteme të ndryshme të transportit publik.</p>
<p>Rreziku i vendit</p>	<p>Tërësia e rreziqeve që lidhen me investimin në një vend të huaj, përfshirë rrezikun e këmbimit, rreziqet ekonomike (ndryshimet në produktin të brendshëm bruto [PBB], rreziku i inflacionit), rreziqet e transferimit (rreziku nga ndonjë bllokadë në riatdhesimin e shpërndarjeve ose të rrjedhës së parave të investitorit), rreziqet politike, rreziqet sociale (përfshirë rreziqet e trazirave të</p>

	<p>përgjithshme), rreziqet rregullatore dhe ligjore (rreziku i dispozitave ligjore ekzistuese që prekin një investitor të huaj, ose që këto dispozita jenë më të komplikuar në vendin e lindjes), korrupsioni, dhe rreziku i sovranit (rreziku nga mos pagesa e detyrimeve financiare nga shteti).</p> <p>Klima e biznesit në një vend (dhe rreziku që ajo të jetë jo e favorshme) mund të konsiderohet pjesë e konceptit të rrezikut të vendit, ose, faktorë veçues për një investitor, teksa shqyrton hyrjen në një treg në zhvillim. Shembuj të klimave të tilla të biznesit përfshijnë legjislacionin e zakonshëm ose të përgjithshëm që prekin një veprimtari tregtare normale (legjislacioni i punës, tatimit, sistemi gjyqësor, etj.), gjendjen e infrastrukturës së nevojshme për veprimtarinë tregtare, zhvillimin ose kufizimet në tregun e furnizimit (posaçërisht disponueshmërinë e fuqisë punëtore të kualifikuar dhe të nënkontraktuesve vendas të fuqishëm financiarisht).</p>
<p>Kërkesat e normës së mbulimit</p>	<p>Matja e aftësisë së partnerit privat për të përmbushur detyrimet e tij financiare. Në aspektin e përgjithshëm, sa më e lartë të jetë norma e mbulimit, aq më e mirë është aftësia e palës private që të përmbush detyrimet e saj ndaj huadhënësve të saj.</p>
<p>Rritja e aftësisë paguese</p>	<p>Instrumente që strukturohen kryesisht për të ofruar një shkallë më të lartë të mbrojtjes për huadhënësit, duke rritur aftësinë paguese të borxhit. Kur ofrohet nga sektori publik, rritja e aftësisë paguese është një formë e financimit publik (me mjete qarkulluese (revolving)) që jo domosdoshmërisht ofron kushte të buta, dhe ul drejtpërsëdrejti koston mesatare të kapitalit të projektit; këto u mundësojnë huadhënësve që të aplikojnë norma më të ulëta interesit për shkak të rritjes së vlerësimit të kreditit.</p> <p>Rritja e aftësisë paguese mund të ofrohet gjithashtu nga bankat shumëpalëshe të zhvillimit (BShZH), agjencitë e kredive të eksportit (AKE) dhe institucione të sektorit privat me linja të vetme (të kreditimit).</p>
<p>Mbështjellje e kredisë</p>	<p>Shih <i>rritja e aftësisë paguese</i>.</p>

Vlerësimi i aftësisë pague	<p>Vlerësim i gjasave që partneri privat të mos kryejë detyrimet e tij. Kjo zakonisht bëhet nga huadhënësit ose nga palë të treta të specializuara, siç janë agjencitë e vlerësimit.</p> <p>Një njësi ekonomike e cila është "e përshtatshme për kredi" konsiderohet të ketë një rrezik të ulët të mospagimit të një detyrimi.</p>
Periudha e korrigjimit të shkeljeve	Një periudhë kohe që i lejohej një pale për të korrigjuar një mospërbushje të kontratës. Për shembull, pala private mund të ketë periudha për korrigjimin e shkeljeve sipas kontratës së projektit, ndërsa nënkontraktuesi mund të ketë periudha për korrigjimin e shkeljeve sipas nënkontratës së ndërtimit.
Data room	Një bazë të dhënash fizike ose elektronike me informacione që janë relevante për projektin, dhe e cila iu vihet në dispozicion ofertuesve.
DB (Projektim-Ndërtim)	Një lloj i prokurimit konvencional ku sektori privat projekton dhe ndërton infrastrukturën, kundrejt një çmimi që financohet nga buxheti publik. Pagesat për punët bëhen zakonisht teksa ndërtimi është në vazhdim e sipër, dhe qeveria merr përgjegjësinë e plotë mbi veprën pas përfundimit të ndërtimit.
DBF (Projektim-Ndërtim-Financim)	Ashtu si në kontratën Projektim-Ndërtim (DB), sektori privat projekton dhe ndërton objektin e ri, por ai paguhet gjatë një rrjedhe afatgjatë pagesash, zakonisht pas komisionimit (të parevokueshëm dhe të pakushtëzuar) dhe jo teksa puna është në zhvillim e sipër. Kjo do të thotë që kontraktuesi duhet të financojë koston e punimeve, duke vepruar si huadhënës ose qiradhënës për palën publike (zakonisht një bankë që siguron financimin kundrejt një pengu bazuar në pagesat e ardhshme të qeverisë). Operimi dhe mirëmbajtja bëhet nga qeveria ose i caktohet një agjencie të veçantë.
DBFM (Projektim-Ndërtim-Financim-Mirëmbajtje)	Një variant i kontratës për Projektim-Ndërtim-Financim-Operim-Mirëmbajtje (DBFOM), në rastet kur operimi <i>nuk përfshihet</i> në objektin e kontratës.
DBFOM (Projektim-	Në një kontratë DBFOM, kontraktuesi zhvillon

<p>Ndërtim-Financim-Operim-Mirëmbajtje)</p>	<p>infrastrukturën me fondet e veta, që do të thotë, ai siguron të gjithë apo pjesën më të madhe të financimit. Kontraktuesi është gjithashtu përgjegjës për menaxhimin e ciklit jetësor të infrastrukturës (duke marrë përsipër rreziqet e kostos të ciklit jetësor) përveç që është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe operacionet aktuale (kontrata shpesh quhet DBFM kur operacionet <i>nuk janë</i> të përfshira në objektin e kontratës).</p> <p>Kontraktuesi mund të paguhet nga përdoruesit ose nga shteti në bazë të pagesave të shërbimeve (pagesa të lidhura me performancën) ose pagesa për përdorim (të lidhura me vëllimin ose përdorimin), por mund të paguhet edhe nga pagesa të shtyra fikse (të paravokueshme dhe të pakushtëzuara, ashtu si në kontratën e tipit Projektim-Ndërtim-Financim [DBF]).</p> <p>Kontratat DBFOM (dhe DBFM) janë lloji i vetëm i kontratave (për nga objekti) që plotësojnë të gjitha kushtet e nevojshme për të qenë PPP. Mirëpo, nëse një DBFOM mund të konsiderohet si një PPP e vërtetë varet nga efektiviteti i transferimit të rrezikut dhe natyra e lidhjeve ndërmjet performancës dhe të ardhurave.</p>
<p>DBOM (Projektim-Ndërtim-Operim-Mirëmbajtje)</p>	<p>Në një kontratë DBOM, kontraktuesi ndërton, ose projektton dhe ndërton infrastrukturën dhe paguhet për punët e ndërtimit kundrejt pagesave publike për ndërtim (si në Projektim-Ndërtim [DB]). Pas ndërtimit, kontraktuesi siguron, operon dhe mirëmban shërbimet (ose vetëm shërbimet e mirëmbajtjes) për të cilat gjithashtu paguhet nga shteti me çmimin e dakordësuar.</p>
<p>Marrëveshja e borxhit</p>	<p>Shihni <i>marrëveshjen financiare</i>.</p>
<p>Norma e Mbulimit të Pagesës së Borxhit (DSCR)</p>	<p>Vlerësimi i aftësisë së shoqërisë së projektit për të përmbushur pagesat e borxhit të çdo viti. Kjo llogaritet duke pjesëtuar fluksin monetar operacional të parashikuar pa përfshirë pagesën e borxhit me pagesën e borxhit të vitit përkatës.</p>
<p>Periudha e përgjegjësisë për defekte</p>	<p>Periudha kohore brenda së cilës kontraktuesi është i detyruar me kontratë të kthehet në kantier për të riparuar defektet që janë shfaqur në punët e kontraktuesit pasi projekti të jetë komisionuar nga</p>

	autoriteti publik.
Rreziku i kërkesës	Rreziku që kërkesa reale (pra, përdorimi ose të ardhurat nga përdorimi i infrastrukturës) të jetë e ndryshme nga sa pritej.
Garancia e rrezikut të kërkesës	Garanci se kërkesa reale do të përmbushë kërkesën e parashikuar. Nëse kërkesa reale është më e vogël se kërkesa e parashikuar, garantuesi bën një pagesë të përfituesi i garancisë.
Kontrata për Projektim dhe Ndërtim (D&C)	Shih <i>kontratën e ndërtimit</i> .
Kushtet e projektimit	Kushtet për projektimin e objektit, ashtu siç përcaktohen në specifikimet e rezultatit/produktit, në dokumentacionin e përgatitjes së ofertës së palës private (dhe të përfshira në marrëveshjen e projektit në mbyllje të kontratës), dhe kërkesat e tjera të projektimit të përcaktuara në marrëveshjen e projektit.
Rreziku i projektimit	Defektet në projektim, si pasojë e të cilave vepra ndërtohet por nuk i përmbush standardet e paracaktuara.
Honorari i zhvilluesit	Në rastin e ofertës së pakërkuar, subjekti i parë propozues merr një honorar nga shteti ose nga ofertuesi fitues. Ky honorar mund të rimbursojë disa kosto të zhvillimit të projektit, konceptimin dhe propozimin e projektit.
Marrëveshje drejtpërdrejtë	e Një marrëveshje e lidhur zakonisht ndërmjet subjektit për qëllime të veçanta (SPV), palës qeveritare dhe huadhënësve. Përndryshe, mund të lidhet edhe ndërmjet SPV-së, huadhënësit dhe nën-kontraktuesve kryesorë. Marrëveshja u jep huadhënësve të drejtat për të ndërhyrë dhe për të marrë përsipër funksionimin e kontratave kryesore të PPP-së. Shih gjithashtu <i>Ndërhyrja</i> .
Detyrimet e drejtpërdrejta	Zotimet e pagesave që shkaktohen pavarësisht nga ndodhja apo jo e një ngjarjeje të pasigurt në të ardhmen.

Normë skontimi	Norma që zbatohet për të llogaritur vlerën aktuale të flukseve monetare të ardhshme, zakonisht përcaktohet në bazë të kostos së kapitalit që është përdorur për të financuar investimin nga i cili pritët fluksi monetar.
Analiza e fluksit monetar të skontuar	Një term i përgjithshëm për analizë, i cili skonton vlerën e ardhshme të një shume parash për të llogaritur Vlerën Aktuale Neto. Shih gjithashtu <i>Vlera aktuale neto</i> .
Nënkontratat ose struktura kontraktuale	Struktura e kontratave ku SPV ua delegon përgjegjësitë, rreziqet, të drejtat dhe detyrimet e tij aktorëve të ndryshëm privatë që marrin pjesë në PPP.
Vlerësimi paraprak (due diligence)	Shqyrtimi dhe vlerësimi i projektit, i kontratave të projektit dhe rreziqeve të ndërlidhura me to. Ai kryhet nga investitorët e projektit dhe huadhënësit përpara se të vendosin të marrin pjesë në projekt apo para se të japin hua për projektin. Termi gjithashtu vlen për aktivitetet e përgatitjes së projektit ose për disa aspekteve të punëve përgatitore që kryhen nga autoriteti i prokurimit para fillimit të tenderit.
Pagesa dinamike rrugore	Nivelet e pagesave rrugore mund të ndryshojnë në kohë reale në mënyrë që t'i përgjigjen ngarkesave. Është e ndërlidhur me objektet ku ekziston një alternativë pa pagesë në mënyrë që shoferët të kenë mundësinë të përdorin opsione me ose pa pagesë, në varësi të nivelit të trafikut dhe procesit. Këto projekte quhen gjithashtu edhe "korsi ekspresi".
Zgjidhja e parakohshme	Zgjidhja e kontratës përpara përfundimit të afatit të kontratës.
Infrastruktura ekonomike	Infrastruktura që bën të mundur veprimtarinë e biznesit, siç janë komunikimi, transporti, si dhe rrjetet e ujësjellësit, të furnizimit me energji elektrike dhe sistemet e menaxhimit të mbetjeve.
IRR-ja financiare	Norma e brendshme e kthimit të projektit (IRR) pasi të

	<p>jenë marrë parasysh eksternalitetet (siç janë kostot dhe përfitimet ekonomike, sociale dhe mjedisore) e që nuk janë përfshirë në llogaritjen e IRR-së financiare.</p>
Empresa mixta	<p>Shih <i>Shoqëritë me kapital të përzier</i>.</p>
Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM)	<p>Procesi që kryhet për të parashikuar pasojat mjedisore, pozitive ose negative, të një projekti. Kjo zakonisht kryhet nga një agjenci ose autoritet tjetër jashtë autoritetit të prokurimit, dhe si rezultat i saj mund të kërkohen apo nevojiten ndryshime në projektimin apo në ndërtimin e projektit.</p>
Ligji mjedisor	<p>Aktet ligjore, nënligjore dhe normative në lidhje me mjedisin (siç janë politikat e mbrojtjes së mjedisit dhe politikat e menaxhimit të mbetjeve industriale).</p>
Kontrata EPC (Inxhinieri, Prokurim dhe Ndërtim)	<p>Një kontratë me çmim fikse, me datë fikse sipas parimit me çelësa në dorë. Zakonisht, ajo përfshin projektimin dhe inxhinierinë, prokurimin ose prodhimin e pajisjeve, dhe ndërtimin dhe ngritjen e një procesi ose impianti tjetër.</p>
Ekuitet	<p>Pjesa e kapitalit aksionar dhe investimeve të tjera, që janë në raport të ndërruar me borxhin kryesor, të ofruar nga anëtarët subjektiv për qëllime të veçanta (SPV).</p>
Dokumentet e ekuitetit	<p>Tërësia e dokumenteve që përbëjnë kornizën për investimin e ekuitetit, dhe sesi investitorët e ndryshëm të ekuitetit do të kontribuojnë në të.</p>
Fluksi monetar neto	<p>Masë e mjeteve monetare që mund të shpërndahen tek aksionarët e ekuitetit pas zbritjes së të gjitha shpenzimeve, riinvestimit dhe pagesës së borxhit.</p>
Investitorët e ekuitetit	<p>Investitorët që financojnë një pjesë të shpenzimeve kapitale të projektit (Capex), zakonisht si kapital aksionar ose si borxh i varur.</p> <p>Kur iu referohemi investitorëve të ekuitetit në këtë Udhëzues Certifikimi për PPP, supozohet se ata janë investitorët e vetëm ose investitorët që kontrollojnë</p>

	<p>shoqërinë PPP.</p> <p>Disa ofrues të ekuitetit mund të mos dëshirojnë të kenë një rol aktiv në ciklin jetësor të investimeve të PPP-së. Kjo gjithashtu përfshin "ofruesit e ekuitetit" dhe "aksionarët".</p>
IRR e kapitalit	Norma e brendshme e kthimit (IRR) në ekuitetin e paguar nga investitorët, e cila rrjedh nga shpërndarjet (kryesisht dividendët, amortizimi i aksioneve të kapitalit, pagesa e borxhit dytësor dhe interesi për borxhin dytësor).
Ofruesit e ekuitetit	Shih <i>investitorët e ekuitetit</i> .
Kthimi i ekuitetit	Norma e brendshme e kthimit që parashikohet të marrë një investitor i ekuitetit.
Aksionet e ekuitetit	Pjesa e kapitalit të një shoqërie që është investuar në subjektin e realizimit të projektit të PPP-së, subjektin për qëllime të veçanta (SPV). Zotërimi i aksioneve të ekuitetit iu mundëson aksionarëve të ekuitetit që të ndikojnë në menaxhimin e SPV-së ose në kontrollin e SPV-së, në varësi të përqindjes së aksioneve që zotërojnë; zakonisht ato palë që kanë investuar kapital të vet në SPV kanë një ekspozim më të lartë ndaj rrezikut.
Ngjarja e mospërmbushjes	Shih <i>Mospërmbushja e kontratës</i>
Pjesa e rrezikut të pritshëm	Vlerë rreziku që shtohet nga partneri privat për të përballuar kostot për shkak të pasigurisë së shkaktuar gjatë vlerësimeve financiare dhe atyre të fizibilitetit.
Vlerësimi ex-post	Vlerësimi që kryhet pasi ka kaluar një periudhë e caktuar nga përfundimi i projektit, me fokus në efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e projektit.
Shprehje interesi	Shprehjet e interesit nga ofertuesit e mundshëm për një projekt. Në disa juridiksione, ky term përdoret në vend të Kërkesës për Kualifikime (KpP).

Kostot e shpronësimit (ose kostot e shpronësimit të tokës)	Në kontekstin e PPP-ve dhe infrastrukturës tjetër, kostot e shpronësimit të pronarëve të pasurive të paluajtshme pronë private, në funksion të përdorimit të asaj pasurie për përfitimet e projektit.
FIDIC (Federata Ndërkombëtare e Inxhinierëve Këshillues)	Një agjenci ndërkombëtare që prodhon kontrata të formës standarde që përdoren për punët e ndërtimit. Kushtet e kontratës FIDIC gjithashtu përdoren gjerësisht në projekte ndërkombëtare, me ndryshime të vogla.
Marrëveshjet financiare	Tërësia e dokumenteve në kuadër të të cilave ofrohet një kredi për zhvillimin e objektit të PPP-së. Përfshihen gjithashtu "dokumentet / marrëveshjet e kredisë", "marrëveshjet financuese" dhe "marrëveshjet e borxhit".
Mbyllja financiare	Pika në të cilën nënshkruhet i gjithë dokumentacioni i projektit, pasi janë përmbushur të gjitha kushtet paraprake për financimin e projektit dhe janë vendosur në dispozicion fondet e projektit.
Fizibiliteti financiar	Shih <i>fizibiliteti tregtar</i> .
Modeli financiar	Tabelar kompjuterik digjital që përfshin, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, të gjitha investimet, të ardhurat, kostot dhe tatimet, si dhe disa parametra analitikë dhe inflacionin relativ. Mjeti gjithashtu përfshin fluksin monetar neto, si të shoqërisë së projektit ashtu edhe të investitorit të kapitalit.
Struktura financiare (nga perspektiva publike)	Për qëllimet e këtij Udhëzuesi Certifikimi për PPP, termi strukturë financiare (nga perspektiva publike), i referohet përcaktimit të mjeteve të kompensimit që do t'i jepen partnerit privat në kontratë dhe kushteve të saj (maturimi, afati, indeksimi dhe rregullimet/zbritjet e mundshme), përfshirë grantet (për të bashkëfinancuar shpenzimet kapitale, ose Capex-in), pagesa të shërbimeve, subvencionet, të drejtën për të vjelë pagesa nga përdoruesit dhe çdo pjesëmarrje të mundshme të palëve publike në ofrimin e financimit (garancitë dhe masat e tjera të përmirësimit të aftësisë paguese, kontributet e ekuitetit ose borxhit). Struktura financiare mund të shihet gjithashtu si profili

	rezultues i pagesave të qeverisë në kuptim të vlerës aktuale neto (VAN) dhe shpenzimeve vjetore publike, ose profili i pagesave që i bëhen partnerit privat (në projekte me rentabilitet të tepërt).
Strukturimi financiar	Në kontekstin e anës private, puna lidhur me planifikimin e miksit të fondeve që do të përdoren për të financuar projektin, posaçërisht në lidhje me shumën e borxheve që duhet të sigurohet.
Financimi	Burimi i parave që nevojiten paraprakisht për të mbuluar kostot e ndërtimit të infrastrukturës. Financimin zakonisht e siguron qeveria përmes tepricave ose huave qeveritare (për prokurimin tradicional të infrastrukturës) ose sektori privat, përmes borxhit apo financimit të kapitalit (për PPP-të).
Fizibiliteti fiskal	Shih <i>përballueshmëria</i> .
Rreziku fiskal	Rreziku që rezultati fiskal për qeverinë (domethënë, pozicioni financiar i qeverisë) të jetë i ndryshëm nga ai i pritur.
Kontrata me çmim fiks	Kontratë me çmim fiks që përcakton një çmim i cili nuk i nënshtrohet ndonjë ndryshimi për shkak të kostos që mund t'i jetë shkaktuar kontraktuesit gjatë realizimit të kontratës. Ky lloj i kontratës i kalon kontraktuesit rrezikun maksimal dhe përgjegjësinë e plotë për të gjitha kostot dhe për fitimin ose humbjen që rezulton.
Forca madhore	Ngjarje të jashtme të paparashikueshme, përtej kontrollit të secilës palë që interpretohen ose përcaktohen me ligj, politikë ose kontratë. Shtrirja e saktë e këtij termi ndryshon në varësi të juridiksionit, por zakonisht përfshin fatkeqësitë natyrore. Shpesh përfshihen edhe disa ngjarje të shkaktuara nga njeriu, siç janë lufta dhe aktivitetet terroriste.
Rreziku i kursit të këmbimit	Rreziqet e lidhura me ndryshimet në valutë/ kursin e këmbimit valutor (Forex). Kjo vlen vetëm kur huatë, kostot ose pagesat e projektit shprehen në një valutë të huaj, qoftë tërësisht ose pjesërisht. Gjithashtu quhet edhe rreziku valutor.

Franshiza	E ngjashme me <i>afermazh</i> , është dhëna me qira ose me koncesion e shërbimeve, por kryesisht ose në thelb, përdoret në kontekst transporti. Franshiza rrallë përfshin kërkesën për investime në infrastrukturë dhe zakonisht infrastruktura menaxhohet drejtpërdrejt nga qeveria ose me marrëveshje të veçantë.
Data e fillimit të shërbimit të plotë	Data në të cilën shërbimet e kontraktuara dhe shërbimet thelbësore të qeverisë mund të fillojnë të ofrohen në objekt dhe nga objekti, e cila zakonisht quhet data e përfundimit ose dita që pason atë datë.
Projekti funksional	Projekti i përgatitur për të paraqitur kërkesat funksionale të një projekti, dhe jo për të dhënë specifikime të kontributeve dhe punëve faktike.
Fondet	Burimi i parave që janë të nevojshme për të përmbushur detyrimet e pagesës. Në kontekstin e PPP-së, fondet iu referohen burimit të parave, për një periudhë afatgjatë, për të paguar partnerin privat të PPP-së për investimet si dhe për kostot operationale dhe të mirëmbajtjes së projektit. Fondet zakonisht burojnë nga tatimet (në PPP-të që paguhen nga qeveria) ose nga tarifat e përdoruesve (në PPP-të që paguhen nga përdoruesi).
Raporti i borxhit ndaj kapitalit	Raporti i borxhit total të shoqërisë ndaj aksioneve të saj të zakonshme (kapitalit). Në këtë Udhëzues Certifikimi për PPP, ky term referohet edhe si levë financiare.
Qeveria	I referohet qeverisë federale, shtetërore dhe / ose vendore/qendrore dhe agjencie/ministrive të tyre të linjës.
PPP-të e tipit qeveria pagan	PPP ku të ardhurat e partnerit privat janë në formën e pagesave buxhetore, zakonisht të lidhura me performancën ose përdorimin.
Financimi i grantit	Ofrimi i pagesave direkte nga buxheti i qeverisë, në mënyrë që të financojë një pjesë të shpenzimeve kapitale (Capex-it). Këto pagesa bëhen zakonisht gjatë ndërtimit (pagesa mujore ose tremujore teksa ndërtimi

	është në zhvillim e sipër ose në bazë të etapave specifike) ose në fund të periudhës së ndërtimit.
Dhënësi	Pala që jep një koncesion, licencë ose ndonjë të drejtë tjetër. <i>Shih autoriteti i prokurimit.</i>
Projektet Greenfield	Nga pikëpamja inxhinierike, këto janë projekte që do të zhvillohen në kantiere që nuk janë përdorur më parë për qëllime industriale, apo objekte në numër më të madh. Nga këndvështrimi i investitorëve, ato janë investime në një PPP që është dhënë kohët e fundit ose është në ndërtim e sipër, dhe ku ka struktura të reja të rëndësishme ose përmirësime madhore të infrastrukturave ekzistuese. Në rastin e kësaj të fundit, në varësi të rëndësisë së vlerës së infrastrukturës ekzistuese, projektet e fushës së gjelbër mund të përkufizohen edhe si projekte të fushës së verdhë ose projekte të fazës dytësore.
Vendimi për dritën jeshile	Vendimi nga autoriteti për të prokuruar projektin. Zakonisht bëhet në fund të Fazës së Vlerësimit, në varësi të konfirmimit pas finalizimit të strukturës dhe hartimit të të gjithë paketës së tenderit.
Fondi i garancisë	<i>Shih fondi për detyrimet kontingjente.</i>
Dorëzimi	Transferimi i aseteve të projektit dhe përgjegjësisë për ato asete te qeveria pas përfundimit ose mbarimit të afatit të kontratës së PPP-së.
Marrja në dorëzim	<i>Shih dorëzimi.</i>
Shërbimet fizike	Shërbime të cilat mundësojnë operimin e përgjithshëm të ndërtesës në përputhje me specifikimet, siç janë mirëmbajtja dhe riparimet.
Kreu i Termave (HOT)	HOT përcakton fushat kryesore financiare që palët e Konsorciumit presin të trajtohen në kontratat kryesore të PPP-së, përfshirë marrëveshjen e projektit, kontratat e ndërtimit dhe kontratat e operimit dhe mirëmbajtjes

	(O&M). HOT përcaktojnë zotimet financiare të palëve, dhe dakordësohen përpara procesit të tenderimit nga palët e konsorciumit.
Mbrojtja (hedging)	Një marrëveshje në tregjet financiare për të mbrojtur shoqërinë e projektit nga luhatjet jo të favorshme në normat e interesit ose në inflacion.
Certifikues i pavarur	<p>Një certifikues zakonisht i emëruar me pëlqimin e palëve private dhe publike, dhe i cili duhet të certifikojë punët e ndërtimit në përputhje me specifikimet e përcaktuara në kontratë.</p> <p>Certifikuesi kryen veprime vijuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Inspekton dhe monitoron punën, merr pjesë në çdo test të performancës gjatë komisionimit dhe këshillon palën private nëse kërkohet ndonjë korigjim • Certifikon që Faza e Ndërtimit ka përfunduar me sukses në përputhje me kontratën e PPP-së • Lëshon certifikatën e përfundimit si dëshmi kontraktuale që Faza e Ndërtimit është përfunduar dhe projekti është në dispozicion për Fazën e Operacioneve. <p>Në disa juridiksione, certifikuesit të pavarur i janë dhënë gjithashtu kompetenca pothuajse gjyqësore për të marrë vendime gjatë procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, të cilat janë detyruese për të gjitha palët.</p> <p>Shih gjithashtu <i>Inxhinier i ndërtimit, zbatimit dhe inspektimit (CEI)</i>.</p>
Inxhinieri i pavarur	Shih <i>certifikues i pavarur</i> .
Rreziqet e inflacionit	Rreziqet për shpenzimet kapitale të shoqërisë së projektit (Capex) ose shpenzimet operacionale (Opex) që rezultojnë nga ndryshimet në normën e inflacionit të çmimeve.
Infrastruktura	Strukturat dhe objektet bazë fizike dhe organizative siç janë ndërtesat, rrugët, furnizimet me energji elektrike, të nevojshme për funksionimin e një shoqërie ose

	ndërmarrjeje.
Fondi i infrastrukturës	Një fond i themeluar për të investuar në infrastrukturë dhe që menaxhohet nga një menaxher fondi.
Korniza institucionale	Grupi i agjencive dhe organeve brenda një qeverie që ndikojnë në menaxhimin dhe qeverisjen e veprimit publik (ose menaxhimin dhe qeverisjen e opsionit të PPP-të, në kontekstin e kornizave të PPP-së).
PPP institucionale	<p>Një formë e PPP-së, e cila është një nën-formë e sipërmarrjes së përbashkët (JV) ose e shoqërisë me kapital të përzier, ku qeveria kontrollon sipërmarrjen e përbashkët të PPP-së dhe zakonisht zotëron shumicën e aksioneve.</p> <p>Sipas këtij Udhëzuesi për Certifikimin e PPP-ve, një PPP institucionale mund të shihet si një PPP e vërtetë me financim privat vetëm kur sektori privat është i përfshirë në mënyrë të konsiderueshme si një investitor i kapitalit (me një përqindje të konsiderueshme të aksioneve të kapitalit), dhe për rrjedhojë merr përsipër rreziqet e projektit, dhe financimi i borxhit është me rrezik performance.</p>
Pronësia intelektuale	Shpikje, dizajne origjinale dhe zbatime praktike të ideve origjinale të mbrojtura me ligj përmes të drejtës së autorit, patentave, dizenjove të regjistruara, të drejtave të planimetrisë së qarkut dhe markave tregtare. Kjo gjithashtu i referohet sekreteve tregtare, know-how pronësor dhe informacioneve të tjera konfidenciale, të mbrojtura nga nxjerrja e jashtëligjshme nga e drejta zakonore dhe përmes detyrimeve kontraktuale shtesë, siç janë marrëveshjet e konfidencialitetit.
Procesi interaktiv i tenderit	I ngjashëm me dialogun konkurrues, në kuptimin që ka ndërveprime të drejtpërdrejta ndërmjet autoritetit dhe disa ofertuesve të mundshëm nga lista e ngushtë, para paraqitjes së propozimit. Dallimi kryesor me procesin e dialogut është se Kërkesa për Propozime (KpP) përcaktohet plotësisht ose thelbësisht në fillimin e fazës së ndërveprimit, ndërsa faza interaktive synon të ndihmojë ofertuesit e ardhshëm të përsosin njohuritë e tyre rreth KpP-së dhe kontratës, dhe jo t'u mundësojë të

	bëjnë sugjerime apo ndryshime në KpP.
Shkëmbimi i normës së interesit (swap)	Një kontratë mbrojtëse për të kthyer një normë luhatëse të interesit në një normë fikse.
Marrëveshja e ndërfaqes	Qëllimi kryesor i një marrëveshjeje të ndërfaqes është të rregullojë marrëdhëniet ndërmjet nën-kontraktuesve kryesorë lidhur me përgjegjësitë e tyre përkatëse në lidhje me projektin, detyrime dhe pagesa të caktuara, dhe rikuperimin e shumave nga njëri-tjetri.
Rreziku i ndërfaqes	Raportet me kontrata ose aktivitete të tjera të qeverisë, ose strukturat vartëse të qeverisë, lidhur me realizimin e suksesshëm të kontratës së PPP-së.
Vendimi për investime	Vendimi nëse një projekt i propozuar është një projekt i mirë. A është qeveria e gatshme dhe e aftë të sigurojë fondet e kërkuara (pasi të ketë llogaritur tarifën e përdoruesve, siç janë taksat rrugore), pavarësisht se si prokurohet projekti?
Investitorët	Shih <i>investitorët e ekuitetit</i> .
Ftesa për Propozime (FpP)	Akti me të cilin autoriteti prokurues kërkon parashtrimin e propozimeve. Në një Kërkesë të Drejtpërdrejtë për Propozim (RFP) (pa dialog ose bashkëveprim të strukturuar), ftesa për të propozuar nënkuptohet në KpP. Mirëpo, në një proces me dialog apo ndërveprim (dhe ndonjëherë në një proces të negociuar), FpP lëshohet në fund të procesit të dialogut ose bashkëveprimit pasi të ketë mbaruar ky proces, ndërsa KpP dhe kontrata janë përfundimtare dhe janë diskutuar dhe sqaruar.
Sipërmarrje e përbashkët (me një palë publike)	Ky term përdoret gjithashtu për t'iu referuar "shoqërive me kapital të përzier" ose " <i>empresas mixtas</i> "
IRR ose IRR-të financiare	Norma e kthimit të një investimi e llogaritur në bazë të fluksit monetar të parashikuar. Norma e brendshme e kthimit (IRR) është gjithashtu norma e zbritjes që barazon vlerën aktuale të një fluksi monetar të ardhshëm me një investim të ardhshëm.

Borxhi dytësor	Shih <i>borxhi i varur</i> .
Treguesit kyç të performancës (KPI)	Treguesit financiarë ose jo-financiarë që përdoren për të matur progresin ose suksesin e palës private gjatë periudhës operative mbi faktorët kritikë të ndërlidhur me projektin, dhe që normalisht ndryshojnë në varësi të shërbimeve të kontraktuara dhe attributeve të tjera të projektit. Treguesit kyç të performancës shpesh përfshihen në marrëveshjen kontraktuale sepse ato mund të shërbejnë si bazë për pagesa të caktuara për palën private.
Defekte latente	Defekte në objekt që askush nuk do kishte mundur t'i konstatonte, dhe efekti i të cilave nuk shfaqet deri në një datë të mëvonshme.
Qiraja	Një institucion ligjor (i ngjashëm me një koncesion dhe që përdoret në disa vende të së drejtës zakonore) që i mundëson qeverisë të japë të drejta ekonomike të infrastrukturës apo pronësinë ekonomike të veprës. Në disa vende, termi "qiraja" mund të rezervohet për kontratat e projektit ku qeveria mbetet përgjegjëse për shpenzimet kapitale.
Korniza ligjore	Sistemi ligjor i një vendi i cili përfshin kushtetutën, organin ligjvënës, vendimet gjyqësore, traktatet dhe ndryshimet paraprake të ligjit.
Huadhënësit	Institucionet që japin hua për projektin: kryesisht bankat dhe investitorët institucionalë përmes obligacioneve të projektit.
Letër zotimi	Një dokument (i cili mund ose nuk mund të jetë detyrues) i lidhur ndërmjet palëve të ndryshme të interesit në një konsorcium. Dokumenti shpreh interesin e tyre për të qenë aksionarë të kapitalit në projekt (që do të ndërmerret) dhe të ofertojnë së bashku si një konsorcium.
Leva financiare	Shih <i>Raporti i borxhit ndaj kapitalit</i> .
Kostot e ciklit jetësor	Të gjitha kostot gjatë jetës së dobishme të

	infrastrukturës, ose gjatë kohëzgjatjes së kontratës që rregullon menaxhimin e infrastrukturës. Këtu përfshihen investimi fillestar / kostot e ndërtimit dhe çdo punë tjetër e mirëmbajtjes që kërkohet për të mbajtur aktivin në një gjendje të pranueshme dhe konstante teknike. Mund të përfshijë gjithashtu gjendjen e nevojshme për të përmbushur kërkesat e performancës të përcaktuara në kontratë.
Rekurs i kufizuar	Financimi me garanci të kufizuara nga sponsorët.
Agjencia e linjës (ose ministria e linjës)	Ministritë ose departamentet qeveritare përgjegjëse për zhvillimin e politikave, planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve specifike. Shembuj të zakonshëm përfshijnë ministrinë e transportit dhe ministrinë e shëndetësisë.
Projekt linear	Një projekt që përfshin ndërtimin e një objekti në një parcelë të gjatë të tokës; për shembull, një rrugë.
Dëmet e Likuiduara (LD)	Niveli i dakordësuar i humbjes kur pala private kryen shkelje të kontratës. Shih gjithashtu <i>gjobat</i> .
Dokumentet / marrëveshjet e kredisë	Shih <i>marrëveshja financiare</i> .
Raporti i mbulimit të jetës së huasë (LLCR)	Raporti i vlerës aktuale neto (VAN) të fluksit monetar të gatshëm në dispozicion për pagesën e borxhit, pjesëtuar me borxhin e papaguar në atë periudhë. VAN matet vetëm deri në maturimin e borxhit. Ky raport ofron një vlerësim të cilësisë së kreditit të projektit nga këndvështrimi i huadhënësit.
Data e përmbylljes	Data e caktuar nga autoriteti prokurues në të cilën duhet të fillojnë shërbimet pa marrë parasysh ngjarjeve apo pretendime që mund të lindin gjatë Fazës së Ndërtimit. Mosfillimi i shërbimeve deri në këtë datë do të çonte në zgjidhje të kontratës.
Rreziqet makroekonomike	Rreziqet për shpenzimet kapitale të shoqërisë së projektit (Capex) ose shpenzimet operative (Opex) që rrjedhin nga ndryshimet në normën e inflacionit, interesit

	apo të shkëmbimeve valutore.
Kontrata e mirëmbajtjes	Shih <i>kontrata e operacioneve dhe mirëmbajtjes (O&M)</i> .
Rreziku i mirëmbajtjes	Rreziku i mirëmbajtjes së papërshtatshme që shkakton ndalim të punës, i cili është i nënkuptuar dhe mbulohet në analizën e rrezikut të disponueshmërisë dhe performancës.
Kontrata e menaxhimit	Një kontratë ku mirëmbajtja afatgjate e infrastrukturës është i vetmi objektivi kryesor i cili i transferohet sektorit privat.
Sistemi i Menaxhimit të Informacionit (MIS)	Një mjet që përdoret për të regjistruar dhe menaxhuar aktivitetet dhe dokumentacionin e një projekti të PPP-së.
Propozimi i iniciuar nga tregu	Shih <i>propozimi i pakërkuar</i> .
Testi i tregut (ose hulumtimi i tregut) për një projekt të PPP-së	Procesi i vlerësimit të reagimit të tregut ndaj një kushti të propozuar të projektit, dhe niveli i interesimit të tregut për projektin.
Testimi i shërbimeve në treg	Metodë për të realizuar testimin e vlerës së shërbimeve të buta të një PPP-je në rastet kur shërbimet e tilla ritenderohen nga partneri privat ndërsa qeveria rregullon pagesën e shërbimeve me vlerën reale të tregut (përfshirë mundësinë e zëvendësimit të ofruesit të shërbimit të butë). Shih gjithashtu <i>kalibrimi</i> .
Borxhi mezanin	Shih <i>borxhi i varur</i> .
Mini-perm	Hua për periudhën e ndërtimit dhe për disa nga vitet e para të operacioneve të projektit, bazuar në teknikën e financave të projektit, i cili ri-financohet më vonë përmes një borxhi afatgjatë.
Shoqëritë me kapital të përzier	Struktura të PPP-së në të cilat autoriteti publik ka pjesëmarrje në kapitalin neto të shoqërisë si një aksionar. Këto janë skema të zakonshme në shtetet me

	<p>sistemin e të drejtës civile (dhe mjaft tipike në vendet spanjolle, ku quhen "<i>empresa mixta</i>", dhe konsiderohen si një lloj i veçantë ligjor i prokurimit ose kontratës publike).</p> <p>Mund të konsiderohen si PPP nëse plotësojnë tiparet e PPP-ve. Shpesh quhen edhe sipërmarrje të përbashkëta (JV).</p> <p>Kur partneri publik kontrollon shoqërinë ose zotëron shumicën e aksioneve, PPP njihet edhe si PPP institucionale.</p>
Simulimi Monte Carlo	Një teknikë e zgjidhjes së problemit që përdoret për të përafëruar probabilitetin e rezultateve të caktuara duke ekzekutuar prova të shumta, të quajtura simulime, duke përdorur variabla rastësore.
Analiza me shumë kritere	Një nën-disiplinë e hulumtimit të operacioneve, e cila shprehimisht merr parasysh kritere të shumëfishta në mjediset vendimmarrëse, ku kostoja dhe çmimi janë njëri prej kritereve kryesore.
Blerësit e mistershëm	Përdorimi i individëve të kualifikuar për të studiuar dhe testuar performancën e shërbimeve që ofrohen nga partneri privat.
Faza e negociatave	Përzgjedhja e ofertuesit / fituesit të preferuar për nënshkrimin e kontratës (në ato procese të tenderimit në të cilat në atë kohë lejohen negociatat).
Vlera aktuale neto (NPV)	Vlera e zbritur e parave të gatshme të një investimi, minus vlera e zbritur e parave që dalin apo shpenzohen. Për të qenë rentabël në masë të mjaftueshme, një investim duhet të ketë një vlerë aktuale neto më të madhe se zero.
Kontraktues i nominuar	Një kontraktues specialist i cili është pjesë dhe rrit besueshmërinë e një konsorciumi, për shkak të aftësive dhe ekspertizës së specializuar, por që nuk bëhet investitor i kapitalit në subjektin për qëllime të veçanta (SPV).

Marrëveshja Konfidencialitetit (NDA)	e	Një marrëveshje në të cilën një palë detyrohet të respektojë detyrimet e ruajtjes së konfidencialitetit si një parakusht për t'i dhënë qasje në informacionet e projektit.
Pa rekurs		Financimi pa garanci nga sponsorët.
Kontrata O & M (Operim dhe Mirëmbajtje)		Një opsion prokurimi për qeverinë, në të cilin një operator privat (me kontratë) operon një aset në pronësi publike për një afat të caktuar. Pronësia e asetit i mbetet organit publik. Gjithashtu përfshin një "kontratën e mirëmbajtjes" dhe "kontratën e menaxhimit të objekteve".
Objektivat (e një kornize të PPP-së)		Çfarë qeveria dëshiron të arrihet nga korniza e PPP-së.
Blerësi i jashtëm		Subjekti që zotohet të blejë rezultatet apo produktet e një projekti.
Tenderi me një fazë		Një proces i tenderimit në të cilin qeveria nxjerr së bashku Kërkesën për Kualifikim (KpK) dhe Kërkesën për Propozim (KpP) ndërsa ofertuesit paraqesin kualifikimet e tyre dhe ofertojnë me një parashtrim të vetëm.
Tender i hapur		Proces i ofertimit i cili është i hapur për çdo ofertues të interesuar, për sa kohë që plotësojnë kriteret e kualifikimit.
Operacionet ose Faza Operative		<p>Periudha nga përfundimi i komisionimit e deri në fund të afatit të kontratës të PPP-së, gjatë së cilës partneri privat është përgjegjës për mirëmbajtjen, dhe në shumë raste për operimin, e infrastrukturës.</p> <p>Gjithashtu njihet edhe si faza e mirëmbajtjes kur nuk përfshihen operacionet. Nganjëherë njihet edhe si Faza Operative (për disa autorë dhe profesionistë, kjo mund të nënkuptojë gjithashtu fazën e projektit që korrespondon me jetën e kontratës).</p>
Operacionet		<u>Koncepti i ngushtë:</u> Kjo nënkupton ose i referohet vjeljes së pagesave ose tarifave nga përdoruesit, ose nënkupton vendosjen e një pike takimi me përdoruesit fundorë (në këtë kuptim, operimi i një sistemi

	<p>hekurudhor nënkupton operimin e shërbimit të transportit, që do të thotë, është përgjegjës për të drejtuar trenat, edhe në rastin kur partneri privat nuk është i ngarkuar me mbledhjen e tarifës nga udhëtarët).</p> <p><u>Koncepti i gjerë:</u> Detyrimet dhe përgjegjësitë tjera, të cilat mundësojnë që infrastruktura të jetë në dispozicion për përdorim. Këto aktivitete nuk janë domosdoshmërisht vetëm veprimtari të mirëmbajtjes në kuptimin e ngushtë të fjalës. Për shembull, për një rrugë, pastrimin e aksidenteve, ose shërbimin e largimit të borës (shërbimi i përdorimit gjatë dimrit).</p>
Opex	Shpenzimet operative (Opex): Kostot për operimin e asetit të infrastrukturës pas dorëzimit të ndërtimit.
Kosto oportune	Dobia që dikush mund të ketë nxjerrë nga ndonjë zgjedhje alternative.
Predispozita optimiste	Predispozita që e bën një person të besojë se ata janë më pak të rrezikuar të përjetojnë një ngjarje negative në krahasim me të tjerët. Për shembull, qeveria mund të ketë predispozitë optimiste në parashikimet e saj lidhur me kërkesën për trafik, gjë që mund të mos jetë e mundur në të ardhmen.
Specifikimet e produktit	Kushtet e shërbimit në kuadër të një PPP-je që përcaktohen në bazë të rezultateve dhe jo mjeteve.
Garancia e shoqërisë mëmë	Një garanci nga shoqëria mëmë e një kontraktuesi për përmbushjen e të gjitha detyrimeve kontraktuale. Shoqëria mëmë merr përgjegjësinë për detyrimet dhe / ose për t'i ofruar kompensim financiar subjektit për qëllime të veçanta (SPV) për të mbuluar koston e dështimit.
Periudha e shpagimit	Kohëzgjatja e nevojshme që fluksi monetar gatshëm i akumuluar nga një investim të barazohet me shpenzimin fillestar.
Mekanizmi i pagesës	Mekanizmi në kontratën e projektit që përcakton marrëveshjet e pagesave sipas një kontrate të PPP-së ndërmjet sektorit publik dhe privat, në PPP-të që

	<p>paguhen nga qeveria. Kjo zakonisht përfshin propozime të hollësishme në lidhje me kohën e pagesave dhe metodologjinë për ndryshimin e pagesave me kalimin e kohës, për shembull, në përputhje me inflacionin.</p>
Zbritjet e pagesave	<p>Zbritjet nga pagesat në një PPP që paguhet nga qeveria.</p> <p>Gjithashtu quhen "rregullime të pagesës" ose "zvogëlime të pagesës".</p> <p>Këto janë rruga direkte për penalizimin e performancës së ulët financiare në PPP-të që paguhen nga qeveria.</p>
Gjobat	<p>Pagesat që i ngarkohen palës private nëse ka shkelje të kontratës.</p> <p>Gjithashtu mund të quhen gjoba të drejtpërdrejta ose gjoba eksplicite, për t'i dalluar nga zbritjet e pagesave.</p> <p>Në shumë vende të së drejtës zakonore, termi "gjobë" ka një kuptim specifik juridik, dhe i referohet një shume të kompensimit, të përcaktuar në kontratë e që nuk është në proporcion me humbjen e mundshme të pësuar nga pala tjetër. Në këto vende, përdoret terminologji tjetër si p.sh. "dëmet e likuiduara".</p>
Sistemi i dënimit	<p>Skema që përcakton kategoritë e shkeljeve dhe nivelet e gjobave që përshkruhen në kontratë.</p>
Pengu i performancës	<p>Shih <i>garancia e performancës</i>.</p>
Garancia e performancës	<p>Garanci me shkrim e lëshuar nga një garantues që është palë e tretë (zakonisht një bankë ose një kompani sigurimesh). Kjo pastaj i dorëzohet autoritetit të prokurimit dhe / ose subjektit për qëllime të veçanta (SPV). Qëllimi është të garantojë se partneri privat dhe / ose kontraktuesi do të përmbushin të gjitha detyrimet e parashikuara në kontratat e tyre.</p>
Sistemi i monitorimit të performancës	<p>Sistem i cili zakonisht përfshin një tërësi të treguesve dhe procedurave të dakordësuara në marrëveshjen e projektit, kryesisht për të përcaktuar nëse pala private i realizon shërbimet e kontraktuara në përputhje me</p>

	specifikimet e shërbimeve.
Pikë performance	Sistem që cakton "pikë" për çdo shkelje të kontratës në mënyrë që të gjurmojë dhe regjistrojë shkeljet - dhe për rrjedhojë edhe performancën - posaçërisht për të kontrolluar rrezikun e partnerit privat që të hyjë në një situatë të shkeljeve të vazhdueshme.
Kërkesat e performancës	<p>Kërkesat e performancës mund të konsiderohen si pjesë e konceptit më të gjerë të "kërkesave teknike" ose "specifikimeve teknike". Në kuptimin e gjerë, këto janë specifikime të kontratës, lidhur me atë se çfarë kërkohet nga partneri privat në aspektin e cilësisë dhe / ose sasisë.</p> <p>Kërkesat e performancës mund të emërtohen gjithashtu "specifikime të produktit/rezultatit" në varësi të kontekstit (shih përkufizimin), ose "kërkesat e shërbimit", por mund të referohen edhe në një koncept më të gjerë si "kërkesa të operimit dhe mirëmbajtjes".</p> <p>Kërkesat teknike në lidhje me ndërtimin mund gjithashtu të quhen "kërkesat e ndërtimit" ose "kushtet teknike të ndërtimit".</p>
Lejet	Leja e planifikimit ose lejet e tjera të nevojshme për ndërtimin dhe operimin e objektit.
Shkelje e vazhdueshme	Mos respektimi i vazhdueshëm nga partneri privat i dispozitave të kontratës së projektit. Shkelja e vazhdueshme (e cila përcaktohet saktësisht në kontratë për nga numri i shkeljeve, akumulimit i gjobave ose akumulimit të pikëve të performancës) mund të rezultojë në zgjidhjen e parakohshme të kontratës.
Rreziqet politike	Rreziqet që lidhen me veprime të qeverisë që prekin partnerin privat ose operacionet e tij.
Kontrata e PPP-së (përkufizimi i gjerë)	Një kontratë afatgjatë ndërmjet një pale publike dhe një pale private, për zhvillimin dhe / ose menaxhimin e një vepre ose shërbimi publik, në të cilin agjenti privat mban rrezikun më të madh dhe përgjegjësinë e menaxhimit gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës. Shpërblimi lidhet,

	<p>në masë të konsiderueshme, me performancën dhe / ose kërkesën ose përdorimin e veprës ose shërbimit.</p> <p>Shih gjithashtu <i>PPP me financim privat</i>.</p>
Marrëveshja e PPP-së	Shih <i>Kontrata e PPP-së</i> .
Kontrata e PPP-së	<p>Kontrata ose marrëveshja ndërmjet autoritetit të prokurimit dhe partnerit privat në një projekt të PPP-së.</p> <p>Termi "kontratë" potencialisht përfshin marrëveshje të tjera që mund të lidhin partnerin privat me palë të tjera të sektorit publik, jashtë autoritetit të prokurimit, për shembull, përmes marrëveshjeve të blerjes së produktit me një autoritet ose organ që është palë e tretë.</p>
Struktura e kontratës së PPP-së ose struktura e kontratës	Tërësia e kushteve kryesore tregtare të kontratës së PPP-së, të cilat në thelb janë ato që lidhen me kushtet financiare ose "strukturën financiare të kontratës së PPP-së" (si do të paguhet partneri privat), dhe kushtet e alokimit të rrezikut ose "struktura e rrezikut të kontratës së PPP-së" (si alokohen rreziqet për secilën palë në kontratë).
Korniza e PPP-së	Rregullat, procedurat e përcaktuara dhe përgjegjësitë institucionale që përcaktojnë mënyrën se si qeveria zgjedh, zbaton dhe menaxhon projektet e PPP-së.
Dokumentet kornizë të PPP-së	Këto janë dokumentet që përcaktojnë kornizën e PPP-së. Këto mund të jenë deklarata të politikave, letra të bardha, ligje, urdhra ekzekutivë, qarkore të departamenteve, manualë ose dokumente të tjera. Llojet e dokumenteve që përdoren ndryshojnë sipas juridiksionit. Në disa raste, korniza mund të përbëhet nga shumë dokumente, që merren dhe lexohen së bashku si një dokumentacion i vetëm. Dokumentet që përbëjnë kornizën mund të bëjnë edhe përcaktimin e programit të PPP-së.
Vëllimi i PPP-ve	Lista e projekteve që qeveria po shqyrton për zbatim si PPP gjatë një periudhe të caktuar kohore (çdo vit, çdo 5 vjet, 10 vjet, e kështu me radhë).

Procesi i PPP-së ose cikli i PPP-së	Hapat që ndjekin projektet e PPP-së në mënyrë që projekti të realizohet. Hapat përfshijnë identifikimin e projektit, vlerësimin e PPP-së, strukturimin e PPP-së dhe hartimin e kontratës, menaxhimin e tenderit dhe procesin e shpalljes së kontratës fituese, dhe menaxhimin e kontratës.
Programi i PPP-së	Mënyrat sesi shteti planifikon të përdorë PPP-në për të arritur ofrimin e shërbimeve me infrastrukturë të përmirësuar. Kjo shkon përtej vëllimit të PPP-ve edhe përfshin planet për zhvillimin e projekteve shtesë, të pidentifikuara. Mund të përfshijë tregues të sektorëve prioritarë ku pritet të përdoren PPP-të dhe masën në të cilën qeveria planifikon të përdorë PPP-së (në krahasim me mekanizmat e tjerë të ofrimit të shërbimeve), qoftë në përgjithësi ose në ndonjë sektor të veçantë.
Mbikëqyrja e programit të PPP-së	Mbikëqyrja e programit të PPP-së dhe e mënyrës sesi ai zbatohet, nga palë që minimumi duhet të jenë të pavarura nga subjektet që zbatojnë programin e PPP-së. Kjo siguron që ata të ndjekin rregullat e përcaktuara dhe t'i shërbejnë interesit publik.
Struktura e projektit të PPP-së ose struktura e projektit	<p>Struktura e projektit të PPP-së i referohet arkitekturës së marrëdhënieve kontraktuale dhe fluksit monetar, që rregullojnë zhvillimin dhe jetën e projektit.</p> <p>Ajo përfshin strukturën e kontratës së PPP-së dhe strukturën e kontratave private (që referohet edhe si strukturë e nënkontratës) që dokumenton dhe shpërndan përgjegjësitë, detyrimet, rreziqet dhe shpërblimet që janë objekt i kontratës së PPP-së.</p> <p>"Strukturimi i projektit të PPP-së" është një term që përdoret për procesin e përgatitjes së strukturës së kontratës së PPP-së dhe të strukturës së procesit të tenderit.</p>
Vlerësimi paraprak i PPP-së	Vlerëson nëse projekti është i plotë si PPP dhe mund të kalojë në fazën tjetër të vlerësimit.
Njësia e PPP-së	Një organizatë qeveritare që mbështet autoritetet kontraktuese në zbatimin e projekteve të PPP-së. Ata shpesh janë pjesë ose degë të një agjencie qendrore,

	siç është ministria e financave.
Studimi i para-fizibilitetit	<p>Vlerësim i parametrave themelorë të një projekti të PPP-së që përdoret për të vendosur nëse duhet të vazhdohet me studime më të thelluara dhe të shtrenjta, siç janë studimet e fizibilitetit dhe zhvillimi i transaksioneve.</p> <p>Shih gjithashtu <i>përmbledhja e planit të biznesit</i>.</p>
Ofertuesi i preferuar	Ofertuesi i identifikuar në fund të procesit të vlerësimit të tenderit si partner i preferuar i qeverisë për të lidhur (ose për të hyrë në negociata përfundimtare për) një kontratë të PPP-së. Ofertuesit të preferuar shpallet fitues i kontratës dhe thirret për nënshkrim të kontratës.
Parakualifikimi	Akti i testimit të ofertuesve të mundshëm për të përcaktuar nëse ata i plotësojnë kriteret e kualifikimit të tipit kalon/nuk kalon përpara nxjerrjes së kërkesës për propozime.
Financimi privat	<p>Çdo financim që sigurohet nga sektori privat e që është me rrezik, që do të thotë, është i varur nga performanca financiare e projektit.</p> <p>Nga një perspektivë e gjerë, çdo financim i siguruar nga sektori privat mund të konsiderohet si financim privat. Në anën tjetër, "financimi privat" mund të konsiderohet si çështje rregullatore: nga këndvështrimi i kontabilitetit dhe raportimit kombëtar, financimi privat nënkupton financimin që nuk konsiderohet si borxh publik, për shembull, nuk është i konsoliduar në bilancin e sektorit qeveritar.</p> <p>Mirëpo, ky Udhëzues për PPP konsideron si "financim privat" çdo financim që sigurohet nga sektori privat i cili është me rrezik në kuptimin që varet nga performanca e kontratës së projektit. Ky aspekt përputhet me konceptin e pronësisë ekonomike të aktivitetit, i cili aplikohet nga disa standarde dhe udhëzues për të vlerësuar nëse një aktiv i PPP-së duhet të konsolidohet ose të regjistrohet në bilancin e qeverisë.</p>
Nisma me Financim Privat (PFI)	Një emër alternativ i prezantuar nga Mbretëria e Bashkuar (MB) për t'iu referuar PPP-ve që paguhen nga

	qeveria.
PPP me financim privat	Një kontratë afatgjatë midis një pale publike dhe një pale private për zhvillimin (ose modernizimin ose rinovimin e konsiderueshëm) dhe menaxhimin e një aseti publik (përfshirë potencialisht menaxhimin e një shërbimi publik të ndërlidhur me atë aset), në të cilën pala private mban rrezikun dhe përgjegjësinë më të madhe për menaxhimin gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, siguron një pjesë të konsiderueshme të financave me rrezikun e vet, ndërsa shpërblimi është i lidhur në mënyrë të konsiderueshme me performancën dhe / ose kërkesën ose shfrytëzimin e aktivitetit ose shërbimit në mënyrë që të harmonizojë interesat e të dy palëve.
Partneri privat	Kundër pala e autoritetit prokurues në kontratën e PPP-së. Një subjekt privat, që është shpallur fitues i kontratës për të ndërtuar dhe operuar një aset shtetëror, dhe që zakonisht themelohet në formë të një Subjekti për Qëllime të Veçanta ose SPV (shih <i>Subjekti për Qëllime të Veçanta</i>). Ai gjithashtu mund t'u referohet aksionarëve të SPV-së, por këta të fundit përkufizohen më saktësisht si "investitorë të kapitalit" ose "aksionarë".
Pala private	Një emër alternativ i shpeshtë dhe nënkupton partnerin privat. Pala ose palët private mund t'u referohen gjithashtu si agjentëve privatë që marrin pjesë në projekt (përfshirë sponsorët, kontraktuesit, huadhënësit dhe investitorët).
Projekte të iniciuara privatisht	Projektet e PPP-së që iniciohen dhe zhvillohen nga shoqëri private me anë të një propozimi të pakërkuar ose të iniciuar nga tregu.
Privatizimi	Transferimi i përhershëm i pasurive publike në pronësi të shtetit të sektori privat.
Profesionist ndershmërisë	i Një ekspert i pavarur i angazhuar të monitorojë procesin e ofertimit në faza kritike, i cili vlerëson dhe raporton nëse procesi është kryer me standardet e kërkuara të ndershmërisë.

<p>Proceset e kritereve të vlerësimit</p>	<p>Procesi për të vlerësuar ofertat e secilit prej ofertuesve në mënyrë që të zgjidhet ofertuesi i preferuar.</p> <p>Në kuptim të gjerë, ekzistojnë dy lloje kryesore të proceseve për sa i përket kritereve të vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Proceset e bazuara vetëm në çmim - ku faktorët teknikë duhet të vlerësohen sipas parimit kalon / nuk kalon. Kjo mund të quhet ankand (edhe pse ankandi është më i përshtatshëm për PPP-të me monetizim aset, që do të thotë, një koncesion jashtë infrastrukturës ekzistuese për krijimin e të ardhurave) dhe si një zgjedhje me kosto më të ulët. • Proceset e bazuara në çmim në kombinim me faktorë të tjerë cilësorë - në thelb kanë të bëjnë me cilësinë e ofertës teknike (në rastin e projekteve projektim-ndërtim dhe në rastin e projekteve operim-mirëmbajtje [O&M]). Kjo mund quhet Përzgjedhja e Bazuar në Cilësi dhe Kosto (QCBS), ose më shpesh si Oferta Ekonomikisht më e Favorshme.
<p>Vendimi i prokurimit</p>	<p>Vendimi për mënyrën më të mirë të prokurimit të projektit. A ofron prokurimi me PPP Vlerë më të mirë të Parasë sesa modeli më i mirë i mundshëm i realizimit të projektit nga sektori publik?</p>
<p>Autoriteti prokurues</p>	<p>Njësia/organi/departamenti brenda një qeverie që tenderon dhe kontraktin projektin. Kundërpala publike në kontratën e PPP-së. Kjo është zakonisht e njëjta njësi ose organ që promovon projektin (promovuesi publik). Për shembull, ministria ose departamenti i transportit, ministria e financave, etj. Gjithashtu përfshin "palë publike", "partner publik", "autoritet publik" dhe "dhënës".</p>
<p>Garancia e projektit</p>	<p>Investim në borxh të tregtueshëm, ku një investitor i huazon para partnerit privat për një periudhë kohe të caktuar, me një normë interesi të ndryshueshme ose fikse, për zhvillimin e një projekti.</p> <p>Financimi i garancisë së projektit është një opsion i zakonshëm për vendet me tregje të zhvilluara mirë të kapitalit, por aplikohet më shpesh si një zgjidhje ri-</p>

	<p>financimi (përmes kredive urë), jo si një mekanizëm i financimit të ndërtimit. Kjo siguron qasje në më shumë resurse për financim afatgjatë, të cilat zakonisht kanë afate më të gjata të borxhit, por është një zgjidhje financiare më pak fleksibël (pasi fondet zakonisht nuk mund të tërhiqen në mënyrë progresive). Për më tepër, ndryshimi i kushteve gjatë kohëzgjatjes së PPP-së është më i vështirë.</p>
Shoqëria e projektit	<p>Shoqëria që vepron si kundërpalë e qeverisë në një PPP. Gjithashtu quhet edhe "Subjekti për Qëllime të Veçanta" (SPV)</p>
Financimi i projektit	<p>Një teknikë për të negociuar dhe dakordësuar financimin afatgjatë të borxhit të një projekti, ku baza e kredisë është fluksi monetar i gjeneruar vetëm nga projekti.</p>
Memorandumi i Informacionit mbi Projektin (PIM)	<p>Një dokument që përcakton detajet e projektit, përfshirë kontratat kryesore të parashikuara dhe të ardhurat e projektuara, që përdoret në kontekstin e negociatave për mbledhjen e fondeve si një dokument që do të paraqitet nga sponsori tek huadhënësit. Gjithashtu mund t'i referohet skicës së projektit që ofrohet nga autoriteti për ofertuesit dhe financuesit e mundshëm gjatë testimit dhe marketingut të projektit para fillimit të tenderit.</p>
Raporti i mbulimit të jetës së projektit (PLCR)	<p>PLCR është raporti i vlerës së tanishme neto të flukseve monetare, që janë në dispozicion për pagesën e borxhit (CFADS), gjatë jetës së mbetur të projektit, me bilancin e borxhit të papaguar. Ky raport është i ngjashëm me Raportin e Mbulimit të Jetës së Huasë (LLCR), por në LLCR, CFADS llogaritet gjatë jetëgjatësisë së planifikuar të huasë, ndërsa flukset monetare për PLCR llogaritet gjatë jetës së projektit.</p>
Skica e projektit	<p>Përkufizimi bazik i projektit nga këndvështrimi teknik.</p>
Përgatitja e projektit	<p>Përbëhet nga aktivitete që trajtohen nga qeveria për të zbutur rreziqet e projektit dhe për të çuar përpara çështjet që janë përgjegjësi e qeverisë përpara se të tenderohet kontrata.</p>
Komiteti drejtues i projektit	<p>Komiteti i përfaqësuesve të departamenteve/agjencive i</p>

	themeluar nga autoriteti i prokurimit për të drejtuar zhvillimin e projektit të PPP-së dhe për t'u marrë me çështjet kryesore.
Promovuesi	Zakonisht i referohet autoritetit të prokurimit që promovon projektin si PPP. Ndonjëherë përdoret edhe për t'iu referuar promovuesit privat. Mirëpo, është më e përshtatshme të përdoret termi "sponsor" për t'iu referuar palës private ose palëve që udhëheqin përgatitjen e ofertave dhe konsorciumin ofertues.
Pasuri publike	Aktivitet fikse, për shembull, aktivitet e blera për përdorim afatgjatë, e që mund të jenë vepra publike, që janë të dedikuara për përdorim publik, ose shoqërohen me ofrimin e shërbimit publik. Pasuritë publike shpesh quhen infrastrukturë publike, duke përdorur infrastrukturën këtu në kuptimin më të gjerë, duke qenë se është lloji i pasurisë publike që zakonisht prokurohet në kuadër të PPP-së.
Analiza e ndikimit të borxhit publik	I referohet analizës që bëhet në disa vende për të përcaktuar nëse asetit i PPP-së duhet të konsiderohet si pronë publike për qëllime të kontabilitetit dhe raportimit, ku detyrimet financiare të kontratës pasqyrohen si borxh publik në pasqyrat financiare kombëtare.
Koncesion i domenit publik	Në disa shtete të të drejtës civile, toka i jepet sektorit privat për 99 vjet; prandaj, kjo kufizon përdorimin e tokës për zhvillim objekteve portuale, të cilat operohen sipas rregullave të caktuara dhe më pas i kthehen qeverisë pas asaj periudhe.
Financim Publik	Një term që nënkupton secilin nga sa më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> • financimin që sigurohet nga qeveria • financimin që njihen në bilancin e qeverisë për qëllime të kontabilitetit (pavarësisht se kush në të vërtetë siguron financimin).
Partneri publik	Shih <i>autoriteti i prokurimit</i> .
Pala publike	Shih <i>autoriteti i prokurimit</i> .
Prokurimi publik	Procesi i ofertimit konkurruese për një kontratë me

	sektorin publik.
Krahasuesi i sektorit publik	Preventivi i kostos (me rrezik të matur), nga këndvështrimi publik, i një projekti që zbatohet me metodën tradicionale të prokurimit. Ky vepron si pikë referimi kundrejt së cilës mund të krahasohet projekcioni i preventivit të kostos për autoritetin sipas opsioni PPP; kjo bëhet për të përcaktuar nëse opsioni PPP prodhon Vlerë të Parasë (VP).
Lista e parregullsive	Listë e defekteve apo mospërputhjeve të vogla të identifikuar gjatë komisionimit, të cilat nuk pengojnë fillimin e shërbimit, por duhet të zgjidhen brenda një periudhe të caktuar kohore.
Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë (SMC)	Sistem që përdoret për të integruar procese të ndryshme të cilat i mundësojnë organizatës identifikimin, matjen, kontrollimin dhe përmirësimin e proceseve të ndryshme themelore të punës, që përfundimisht çojnë në përmirësimin e performancës së punëve dhe zbutjen e rrezikut të ndërtimit.
Faktori shtrëngues (ratchet)	Në kontekstin e mekanizmave të pagesave, faktori që rritë vlerën e zbritjeve që aplikohen në pagesa, në mënyrë që të penalizohet performanca e ulët e përsëritur ose e vazhdueshme, ose mungesa e disponueshmërisë që vazhdon e pazgjidhur.
Periudha e korrigjimit	Koha që i jepet partnerit privat për të korrigjuar ndonjë shkelje të caktuar që ndikon në disponueshmërinë e asetit për përdoruesit. Kjo periudhë përcaktohet në kontratë nga autoriteti publik.
Projekti referencë	Projekti referencë është propozimi teknik i një projekti, që shërben për t'u kopjuar nga të tjerët. Palët e treta mund të kenë të drejtë të përmirësojnë ose modifikojnë projektin sipas nevojës.
Ri-financimi	Ndryshim në strukturën financiare dhe/ose kushtet financiare, duke rinegociuar borxhin ekzistues ose duke mbledhur fonde të reja për të zëvendësuar ofruesit aktualë të fondeve. Disa kontrata parashikojnë që përfitimet nga ri-financimi të ndahen me partnerin publik.

<p>Ndërmarrje të rregulluara në pronësi të investitorëve</p>	<p>Në shumë shtete (përfshirë Australinë, Francën, Mbretërinë e Bashkuar [MB] dhe Shtetet e Bashkuara [SHBA]), infrastruktura e ndërmarrjeve publike (si prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, ose sistemet e telekomunikacionit) mund të mbahen në pronësi të subjekteve private, e jo të jepen me koncesion.</p>
<p>Çlirimi nga përgjegjësia</p>	<p>Ngjarjet e rrezikut, për të cilat kontrata parashikon çlirim nga përgjegjësia. Nëse ngjarja ndodh dhe ndikon në aftësinë e partnerit privat për të kryer ose përmbushur ndonjë detyrim, shkelja e mundshme e kontratës nuk konsiderohet si shkelje. Në këtë rast nuk aplikohen gjopa apo arsye të mundshme për ta konsideruar partnerin në shkelje.</p>
<p>Fondi i Rinovimit</p>	<p>Llogari në të cilën depozitohen fondet nga partneri privat ashtu që të mund të mbulojë kostot e parashikuara të rinovimit të infrastrukturës gjatë jetëgjatësisë së kontratës.</p>
<p>Kërkesë për Propozim (KpP)</p>	<p>Tërësia e dokumenteve që publikohen nga autoriteti i prokurimit të cilat përcaktojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bazat ose kriteret për dorëzimin e propozimit (cilat dokumente dhe në cilin format e përmbajtje duhen paraqitur nga ofertuesi) • Baza e kriterëve të vlerësimit për përzgjedhjen e ofertuesit të preferuar ose fituesit të kontratës • Kontrata PPP që do të nënshkruhet me ofertuesin e suksesshëm dhe informacione të tjera të bashkangjitura, siç janë formularët, modelet standarde, informacione plotësuese për qëllime referimi, etj. <p>Në proceset e tenderimit të hapur me një fazë, përmbajtja e Kërkesës për Kualifikim (KpK) përfshihet në të njëjtin grup dokumentesh, për shembull, Kërkesa për Propozim (KpP) përfshin edhe rregulloret e KpK-së. Në disa procese me dy faza, ku merret parasysh një fazë dialogu ose një lloj ndërveprimi i strukturuar (kryesisht në rastin e “dialogut konkurrues”), KpP-ja dhe kontrata janë provizore (ose madje jo-ekzistente në disa dialogje konkurruese) derisa të finalizohet dialogu, dhe</p>

	<p>të përcaktohet kontrata dhe kërkesat përfundimtare ose definitive për dorëzim dhe vlerësim. Zakonisht në këto procese, KpP-ja e parë quhet "dokument përshkrues".</p> <p>Shih edhe <i>faza e 'ofertimit' KpP, faza e vlerësimit të KpP, faza KpP, përgjigja ndaj KpP.</i></p> <p>Në disa vende, KpP mund të quhet edhe si Kërkesë për Ofertë (KpO).</p>
Kërkesa për Kualifikim (KpK)	<p>Kjo është kërkesa e qeverisë për kualifikime, që nxirret në treg në lidhje me projektin.</p> <p>Tërësia e dokumenteve që publikohen nga autoriteti i prokurimit e që përbëjnë bazën e kualifikimit, e potencialisht edhe para-përzgjedhjen e kandidatëve (lista e ngushtë). Më pas, kandidatët e kualifikuar (ose ata në listën e ngushtë) ftohen të dorëzojnë propozimin (ose të hyjnë në fazë të re para dorëzimit të ofertave, siç është faza e dialogut ose faza interaktive).</p> <p>Përgjigja ndaj KpK është Dorëzimi i Kualifikimeve (DK). Kjo gjë mund të quhet edhe si dorëzimi i Shprehjes së Interesit (SHI).</p>
Rrezu i mbajtur	<p>Vlera e atyre risqeve ose pjesëve të një rreziku që qeveria mban në një projekt PPP.</p>
Projekti krijues i të ardhurave	<p>Krijuesi i të ardhurave është projekti që gjeneron të ardhurat e veta dhe siguron të ardhura të mjaftueshme për ta bërë projektin financiarisht të realizueshëm pa financim publik. Një shprehje tjetër ekuivalente është "projekt i vetë-financueshëm". Nganjëherë përdoret shprehja "projekt i tej-realizueshëm" kur ka shenja të qarta të suficitit substancial të të ardhurave dhe vlerës financiare mbi tavanin e fizibilitetit.</p> <p>Këto projekte janë PPP me pagesë nga përdoruesit, por të ardhurat mund të përfshijnë edhe të ardhura nga palë të treta, për shembull, shitja e energjisë së prodhuar nga një impiant për trajtimin e mbetjeve në një projekt të energjisë nga mbeturinat, ose të ardhura anësore (të ardhura dytësore kolaterale me më pak relevancë, të përfituara me anë të biznesit anësor, që do të thotë, biznese që nuk janë thelbi i objektit të PPP, si të ardhurat nga reklamat në një projekt hekurudhor, apo</p>

	restorantet/dyqanet në një aeroport).
Rreziku ndaj të ardhurave	Shih <i>rrezikun e kërkesës</i> .
Faza e “ofertimit” në KpP	Pjesa e fazës së Kërkesës për Propozim (KpP) ku ofertuesit përgatisin përgjigjen e tyre ndaj KpP-së.
Faza e vlerësimit të KpP-së	Pjesa e fazës së Kërkesës për Propozim (KpP) ku qeveria vlerëson përgjigjet ndaj KpP-së.
Faza KpP	Faza që përfshin shpalljen e Kërkesës për Propozim (KpP) për ofertuesit, për përgjigje të hollësishme dhe të detyrueshme ndaj KpP, e ndjekur nga vlerësimi dhe përzgjedhja e ofertuesit të preferuar.
Përgjigja ndaj KpP	Propozim nga një ofertues në përgjigje ndaj Kërkesës për Propozime (KpP) të shpallur nga qeveria për një projekt.
E drejta e kalimit	E drejta mbi një hapësirë tokësore, që zakonisht kërkohet në projektet lineare të infrastrukturës, si rrugët ose tubacionet.
Barriera virtuale	Detyrimet e shoqërisë së projektit janë të ndara me barrierë virtuale nga ato të investitorëve të kapitalit (domethënë, shkelja e një detyrimi nga shoqëria e projektit nuk konsiderohet si shkelje e detyrimit nga investitorët e kapitalit), ndërsa borxhi sigurohet kundrejt fluksit monetar të projektit.
Rreziu	Një ngjarje e pasigurt, e cila nëse ndodh, mund të bëjë që rezultatet faktike të projektit të ndryshojnë nga rezultatet e pritura.
Alokimi i rrezikut	Alokimi i pasojave të secilit rrezik te njëra nga palët në kontratë, ose dakordësia për t'a trajtuar rrezikun përmes një mekanizmi të caktuar që mund të përfshijë ndarjen e rrezikut.
Vlerësimi i rrezikut	Vlerësimi i gjasave që risqet e identifikuar të materializohen dhe shkalla e pasojave nëse ato materializohen.

Primi i rrezikut	Normë plotësuese e kërkuar e kthimit që duhet t'u paguhet investitorëve që marrin pjesë në investime me rrezik për të kompensuar rrezikun.
Strukturimi i rrezikut	Përcaktimi i alokimit optimal të rrezikut për kontratën, tepër të vendosur se cilat risqe do t'i caktohen partnerit privat dhe në çfarë mase, si dhe cilat risqe do të mbahen ose ndahen nga autoriteti publik dhe në çfarë mase.
Fushëveprimi (i kornizës PPP)	Llojet e projekteve dhe sektorët ku aplikohet korniza PPP.
Investitorët sekondarë	Investitorët që investojnë në partnerin privat pas mbylljes financiare (zakonisht në vitet e para të Fazës së Operimit), duke blerë aksionet e tyre nga investitorët primarë.
Borxhi prioritar	Forma kryesore e borxhit të marrë nga partneri privat, i cili është më prioritar ndaj borxheve tjera të pasiguruara ose ndryshe më "inferiore", që do të thotë, borxhi prioritar zakonisht ka përparësinë e parë për kthim, ndërsa huadhënësit e borxhit prioritar kanë kompetenca vendimmarrëse me përparësi ndaj huadhënësve të borxhit inferior.
Kontratë shërbimi	Transferimi i operimit të një shërbimi publik në kuptimin e ngushtë ligjor, për shembull një shërbim që lidhet me ujin ose transportin e udhëtarëve, e jo me mirëmbajtjen apo operimin e rrugës. Në juridiksionet anglosaksone, shprehja "kontratë shërbimi" nuk ka kuptim specifik juridik, si dhe përdoret për një larmi të gjerë të kontratave të shërbimit publik, zakonisht ato me afate relativisht të shkurtra.
Dështimi i shërbimit	Dështimi i shkaktuar në rastin kur pala private nuk i ofron shërbimet në pajtim me specifikimet e kontratës së shërbimeve.
Huadhënia në hije	Huatë e dhëna nga huadhënësit e pa-rregulluar.

Çmimet në hije	Në kontekstin e analizës ekonomike, çmimet e përshtatura si duhet për të përballuar pa-përsosmëritë e tregut siç janë kufizimet e këmbimit valutor, kostot e krahut të punës dhe konsumi i energjisë. Këto nuk duhet të ngatërrohen me taksat në hije ose tarifatat në hije.
Taksat në hije (pagesë në hije)	Taksat në hije ose pagesat në hije (gjithashtu të njohura si tarifatat në hije) janë taksat ose tarifatat e paguara nga qeveria në vend të përdoruesit. Shprehja taksë në hije përdoret për llojin e veçantë të tarifës që përdoret për projektet e rrugëve. Pagesat në hije për vëllim janë një nga dy llojet kryesore të mekanizmave të pagesave.
Aksionarët	Aksionarët janë investitorët e kapitalit që zotërojnë aksione në subjektin për qëllime të veçanta (SPV) — duke theksuar që investitori mund të investojë në instrumente të tjerë të ndryshëm nga aksionet e kapitalit, por normalisht investon edhe në aksione kapitali).
Marrëveshja e aksionarëve	Dokumenti që lidhet mes ofruesve të kapitalit të subjektit për qëllime të veçanta (SPV), i cili përcakton se si ata do të punojnë së bashku për ta administruar subjektin.
Ofertuesi në listën e ngushtë	Ato palë të ftuara për të paraqitur propozimin në përgjigje të Kërkesës për Propozime (KpP) për një projekt në të cilin qeveria lejon një numër të kufizuar të ofertuesve të parakualifikuar që të vazhdojnë në fazën e KpP.
Parimi “arka-vetme”	Një marrëveshje ku qeveria siguron financim nga buxheti i saj vjetor për nevojat e përgjithshme të publikut, por pa pasur detyrimin për të financuar një projekt specifik.
Infrastruktura sociale	Infrastruktura që mbulon shërbimet sociale: spitale, shkolla dhe universitete, burgje, banesa, gjykata, etj.
Kushtet e buta	Kushte më të favorshme sesa kushtet aktuale të tregut.
Kredi të buta	Kredia e butë jepet nga autoriteti i prokurimit. Zakonisht

	<p>është kredi e varur, por me prioritet mbi kapitalin, duke përfshirë borxhin e varur të ofruar nga investitorët e kapitalit. Është po ashtu e zakonshme që kredia e butë të jetë në formën e një kredie pjesëmarrëse, që do të thotë, qeveria merr një pjesë të rritjes potenciale të vlerës së projektit në këmbim për kushtet nën vlerën e tregut. Kompensimi dhe të drejtat për të pranuar shpërndarjen duhet të përshkruhen qartë në kontratë.</p>
Shërbime të buta	<p>Shërbimet që lidhen me menaxhimin operativ të një projekti (që përfshinë zëra si pastrimi, furnizimi me ushqim dhe dezinfektimi) normalisht përfshijnë komponent me fuqi të madhe punëtore, si dhe nuk janë të lidhura përbrendësisht me aktivet e kapitalit. Këto shërbime, në rastet kur transferohen te sektori privat sipas një marrëveshjeje PPP, shpesh i nënshtrohen rregullimeve të testimit të tregut dhe/ose atyre të krahasimit sipas kontratës së PPP.</p>
Fondet sovrane	<p>Fond që zakonisht krijohet apo kontrollohet nga një qeveri për të investuar në shtete të tjera.</p>
Subjekti për qëllime të veçanta (SPV)	<p>Subjekt i krijuar për të marrë përsipër një detyrë apo projekt të vetëm, me qëllim që të mbrojë aksionarët me përgjegjësi të kufizuar, shpesh përdoret për financim të kufizuar ose pa rekurs. Në krijimin e një konsorciumi të projektit, sponsori ose sponsorët zakonisht themelojnë një partner privat, në formën e subjektit për qëllime të veçanta (SPV), i cili lidh kontratën me qeverinë. SPV-ja është subjekt i krijuar për të vepruar si përfaqësues ligjor i një konsorciumi projekti, pa dosje historike financiar apo operative të cilën qeveria do të mund ta vlerësonte. SPV/subjekti për qëllime të veçanta është person juridik pa asnjë aktivitet tjetër përveç atyre që lidhen me projektin. Kjo shprehje përfshinë edhe “partnerin privat” ose “shoqërinë e projektit”.</p>
Sponsori	<p>Një apo më shumë shoqëri private që marrin përsipër rolin udhëheqës në përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, si dhe zakonisht gjatë jetëgjatësisë së kontratës, derisa potencialisht të largohet, duke shitur interesat e saj të kapitalit.</p>
Kontratrat standarde	<p>Kontratrat standarde përfaqësojnë formulimin e saktë për</p>

	dispozitat e caktuara të kontratës ose klauzolat e kontratës që agjencitë publike duhet të përdorin (ose në të kundërt duhet të dokumentojnë ose arsyetojnë devijimet prej tyre).
Periudha e pritjes	<p>Periudha në të cilën një proces vihet në pritje për t'i lejuar palës tjetër ose palëve tjera që të ndërmarrin masa. Në kontekstin e PPP, zakonisht i referohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • një periudhë e detyrueshme kohore e nevojshme ndërmjet dhënies së kontratës dhe nënshkrimit të asaj kontrate për të lejuar ndonjë ankesë ndaj vendimit të dhënies së kontratës • një periudhë kohore e rënë dakord me kontratë në të cilën njëra palë nuk duhet të ndërmarrë veprime të caktuara.
Rregulloret e ndihmës shtetërore	Rregulloret që kufizojnë nivelin e përkrahjes financiare që mund t'i jepen një projekti përmes huave publike ose huave të dhëna nga një agjenci publike, si dhe garancive.
Ndërmarrje shtetërore	Shoqëri ose ndërmarrje e krijuar nga dhe në pronësi të vetë qeverisë.
Marrja përsipër	Opsioni i qeverisë ose huadhënësit për të marrë përgjegjësitë kontraktuale të një pale të projektit përmes menaxhimit të kontratës së tyre në rastet kur ajo palë nuk po i përmbushë detyrimet e saj sipas asaj kontrate.
Fondi strategjik i investimeve	Një fond i strukturuar përmes të cilit qeveria mund të investojë në projekte në shtetin e vet.
Nënkontrata	Një kontratë midis palës private dhe një pale të tretë, që parashikon kryerjen e një pjese të detyrimeve të palës private sipas kontratës PPP.
Paraqitja e Kualifikimeve	Dorëzimi i dokumenteve të kërkuara për kualifikim nga ofertuesi i mundshëm.
Borxhi i nënrenditur	Borxh i cili, me marrëveshje ose strukturë ligjore, është i nënrenditur ndaj një borxh tjetër (prioritar), që i

	<p>mundëson atyre huadhënësve (prioritarë) të kenë përparësi në qasjen në shumat e paguara huadhënësve nga huamarrësi, herë pas here, si dhe në asetet apo të ardhurat e huamarrësit në rast mospërmbushjeje. Kjo përparësi mund të jetë detyruese për likuiduesit ose administratorët e huamarrësit.</p>
Kosto e zhytur	<p>Një kosto që është shkaktuar tashmë dhe nuk mund të rikuperohet.</p>
Furnizuesit	<p>Grup nënkontraktues që mund të jetë i specializuar në një lloj produkti ose shërbimi që përdoret për ndërtimin, operimin apo mirëmbajtjen e objektit.</p>
Sfida zvicerane	<p>Në rastin e ofertave të pakërkuara, kryhet procesi i hapur i tenderimit. Nëse ai propozues nuk fiton, ka mundësinë të barazojë ofertën fituese dhe të fitojë kontratën.</p>
Sindikata	<p>Procesi me të cilin bankat që fillimisht bien dakord t'i sigurojnë një hua palës private ulin sigurimet e garantuara të tyre duke vendosur një pjesë të kredisë të bankat tjera.</p>
Risqet sistemike	<p>Risqet në lidhje me kushtet e përgjithshme ekonomike të cilat nuk mund të klasifikohen në strategji specifike dhe mund të paguhen vetëm nga rritja e përgjithshme në shkallën e kthimit të asetit.</p>
Mbyllja teknike	<p>Në një proces mbylljeje me dy faza, kjo është faza e punimeve ku certifikuesi i përfundimit është i kënaqur me të gjitha testet e specifikuara dhe kriteret e përfundimit.</p>
Kërkesat teknike	<p>Detajet teknike në lidhje me projektin që lejojnë një përcaktim të saktë të projektimit të infrastrukturës dhe karakteristikave të shërbimit që do të zbatohet, dhe që trajtojnë se si do të realizohet kryerja dhe ofrimi i shërbimit. Kërkesat teknike të përkufizuara qartë janë esenciale për vlerësimin dhe alokimin e kostove për analizën e fizibilitetit financiar të projektit.</p>

Vjetërsimi teknologjik	Vjetërsimi teknologjik i referohet rrezikut që pajisjet e caktuara të bëhen joadekuate ose të vjetruara për qëllimin e shërbimit.
Pamaturia	<p>Një ofertë e bërë me kushte që mund të konsiderohen të pamatura me shpresën për ta fituar projektin dhe më pas të jepet mundësia e negociimit të epilogut më të favorshëm. Në disa juridiksione, si Spanja, është zakon të vendoset një prag i pamaturisë në terma relativë.</p> <p>Për shembull, çdo ofertë që është nën ofertën mesatare me më shumë se 15 për qind, konsiderohet shumë agresive për qëllime të vlerësimit. Sipas legjislacionit spanjoll, autoriteti mund t'i japë ofertuesit mundësinë për ta shpjeguar dhe argumentuar arsyetimin e asaj oferte dhe mund të kërkohet siguri shtesë nga autoriteti për të garantuar disponueshmërinë e fondeve.</p>
Procesi i tenderit	Procesi me të cilin ftohen të ofertojnë palët e interesuara për ta kryer projektin. Procesi i tenderimit shfrytëzon presion konkurrues në mes të ofertuesve për ta marrë çmimin dhe kushtet më të mira.
Afati	Kohëzgjatja e kontratës PPP, ose periudha deri në datën finale të ripagimit të borxhit.
Zgjidhja për përshtatshmëri	<p>Zgjidhja e kontratës nga qeveria edhe në rastet kur nuk ka mospërputhje apo arsye të tjera për ta zgjidhur kontratën. Qeveria mund të zgjidhë kontratën në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit, nisur nga interesi publik.</p> <p>Njihet gjithashtu si “zgjidhje e njëanshme”.</p>
Pagesa për zgjidhjen	<p>Një pagesë e bërë nga qeveria sipas kontratës PPP, pas zgjidhjes së marrëveshjes së projektit.</p> <p>Njihet gjithashtu si “kompensim për zgjidhjen”.</p>
Të ardhurat e palëve të treta	Mundësia e shoqërisë së projektit për të gjeneruar të ardhura, krahas të ardhurave nga përdoruesit ose autoriteti publik.

Prokurimi tradicional	Dorëzimi i infrastrukturës dhe shërbimeve shoqëruese nga qeveria duke përdorur një proces prokurimi për projektim dhe ndërtimit, ose një proces tjetër prokurimit që përdoret tradicionalisht nga qeveria.
Rreziku i transferuar	Vlera e atyre risqeve (nga perspektiva e qeverisë) që ka të ngjarë t'i alokohet palës private sipas një projekti PPP.
Kontrata me çelësa në dorë	Një kontratë me një pikë të vetme përgjegjëse për projektimin, zbatimin, për sigurimin e pajisjeve, dhe për ndërtim.
Tenderi me dy faza	Proces tenderimi në të cilin qeveria fillimisht nxjerr Kërkesën për Kualifikime (KpK), dhe më pas (pasi vlerëson kualifikimet e ofertuesve të mundshëm) u dërgon Kërkesën për Propozime (KpP) vetëm ofertuesve të para-kualifikuar (ose në disa procese, atyre në listën e ngushtë).
Zgjidhja e njëanshme	Shih <i>zgjidhja për përshtatshmëri</i> .
Tarifa unitare	Një shprehje për pagesat e kryera nga qeveria sipas një kontrate PPP të tipit qeveria pagan.
Kompensimi unitar	Shih <i>tarifa unitare</i> .
Pagesa unitare	Shih <i>tarifa unitare</i> .
Propozim i pakërkuar	Një propozim i bërë nga një palë private për ta realizuar një projekt PPP. Ai paraqitet me iniciativë të firmës private, jo në përgjigje të kërkesës nga qeveria.
Pagesat paraprake ose tarifa e koncesionit	Një mekanizëm i ndarjes së pagesave ku autoriteti publik duhet të paguhet paraprakisht nga partneri privat në rast se projekti tregon potencial të të ardhurave më shumë sesa kërkohen për fizibilitet financiar.
Kontrata kryesore	Marrëveshja kontraktuale ndërmjet autoritetit të prokurimit dhe partnerit privat.
Tarifat e përdoruesit	Pagesat e bëra nga përdoruesit e infrastrukturës, të tilla si taksat rrugore në një projekt të rrugës me pagesë.

PPP përdoruesi-paguan	<p>Një projekt PPP në të cilin të ardhurat për partnerin privat bazohen në pagesat e përdoruesve (për shembull, tarifat rrugore).</p> <p>Ky Udhëzues i Certifikimit PPP konsideron çdo PPP ku shumica e të ardhurave vijnë nga përdoruesit si PPP ku paguan përdoruesi, edhe nëse të ardhurat janë hibride, për shembull, duke përfshirë një formë të pagesave publike.</p>
PPP-të e financuara nga përdoruesi	Shih <i>PPP përdoruesi-paguan</i> .
Prodhimi i vlerës	Modifikimi i projekteve dhe sistemeve sipas analizës së vlerës, zakonisht me synim për t'i ulur kostot.
Vlera e Parasë (VP)	<p>Duke folur gjerësisht, përfitimi ose prodhimi i Vlerës së Parasë do të thotë se nga paratë e shpenzuara janë marrë përfitime maksimale të mundshme, domethënë vlera e produktit ose shërbimit të marrë është e barabartë ose e tejkalon shumën e shpenzuar. Vendimi për të shpenzuar (ose investuar në këtë kontekst) është vendim i mençur pasi po krijon vlerë neto për paguesin.</p> <p>Koncepti i “Vlera e parasë” përdoret shpesh në çdo vendim investimi që merret nga qeveria për të nënkuptuar se investimi po krijon vlerë neto për shoqërinë (ose për tatimpaguesin), dhe është testuar nga teknikat e kosto-përfitim (veçanërisht Analiza Kosto-Përfitim). Sidoqoftë, në kontekstin e PPP-ve, Vlera e Parasë përdoret në kuptim më specifik - shih Vlera e Parasë (në kontekstin e PPP-ve) më poshtë.</p>
Vlera e Parasë (në kontekstin e PPP-ve)	<p>Përfitimet në raport me kostot e prokurimit të një projekti duke përdorur PPP krahasuar me opsionet tjera të prokurimit. Zakonisht njihet me shkurtësën e saj Vlera e Parasë (VP). Në kontekstin e PPP-ve, Vlera e Parasë mund të testohet në dy pika të ndryshme në ciklin e projektit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • gjatë vlerësimit dhe strukturimit, testi VP mund të përcaktojë nëse alternativa PPP është një mekanizëm prokurimi që ka të ngjarë të prodhojë vlerën më të mirë ekonomike për autoritetin publik ose një vlerë më të mirë sesa mekanizmi tradicional i prokurimit; • gjatë vlerësimit të ofertave, testi VP mund të përcaktojë nëse ofertat ofrojnë Vlerën e Parasë

	<p>kundrejt kosos së prokurimit konvencional.</p> <p>Një rezultat pozitiv i VP-së ose VP-së së pritur nga opsioni PPP është rezultati i kombinimit të efikasitetit të sektorit privat dhe inovacionit, transferimit të rrezikut, kosos së tërë jetës dhe shërbimit të ofruar nga objekti.</p>
Testimi i vlerës	<p>Një ushtrim, qëllimi i të cilit është të testojë kostot e shërbimeve të buta që ofrohen brenda kontratës PPP kundrejt çmimit të tyre të tregut në një moment të caktuar. Kjo bëhet për ta përshtatur shumën e pagesave të shërbimeve në mënyrë të tillë që të pasqyrojë çmimin e tregut.</p> <p>Metodat më të zakonshme për testimin e vlerës janë krahasimi dhe testimi i tregut.</p>
Financimi i hendekut të fizibilitetit	<p>Një skemë ku projekteve me fizibilitet të ulët financiar u jepen grante (ose përkrahje tjetër financiare nga qeveria) deri në një përqindje të përcaktuar të kosos së projektit, duke i bërë ato financiarisht të realizueshme si PPP. Zakonisht projekti i jepet ofertuesit i cili bën ofertë për një projekt me mbështetjen financiare më të vogël nga qeveria.</p>
Zgjidhja vullnetare	<p><i>Shih zgjidhja për përshtatshmëri.</i></p>
Kostoja mesatare e ponderuar e kapitalit (KMPK)	<p>KMPK është kostoja mesatare e të gjitha burimeve të financimit privat të projektit. Është mesatare e ponderuar e kosos së burimeve të kapitalit dhe kosos së borxhit.</p>
Gatishmëria për të paguar	<p>Vullneti dhe aftësia e përdoruesve të një koncesioni për të paguar taksat ose tarifatat tjera të përdorimit që kërkohen nga koncesionari.</p>
Fitimet ekstra	<p>Fitimet e ndjeshme politikisht të bëra nga investitorët në PPP nga kthimi i lartë i investimeve, rifinancimi i borxhit ose shitja e investimeve të tyre.</p>
Kapitali punues	<p>Shuma e fondeve që nevojiten për operimin dhe kostot e financimit të kryera para marrjes së të ardhurave.</p>

Projektet 'Yellowfield'	PPP-të ku investimi fillestar ka të bëjë me rinovimin, meremetimin ose zgjerimin e infrastrukturës ekzistuese. Ato gjithashtu referohen si projekte të fazës dytësore.
--------------------------------	--